

Procesverbal

Nga seanca e IV-të (katërtë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 29.03.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e kaluar e Kuvendit...,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor Financiar/2017,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara vetanake të vitit 2917 në vitin 2018,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e e Rregullores për lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave komunale,
5. Rishikimi i Vendimit të MAPL-së lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete të KK-së, dhe
6. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën e deklarimit të delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse jo, miratohet, njëzëri, rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse nuk ka, konstatoj se miratuar Procesverbalin e seancës së kaluar.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit Vjetor Financiar/2017 dhe për këtë pikë, me një përmbledhje të shkurtër, do të paraqitet kryetari i Komunës

z.Samidin Xheladini- Dua të theksoj se këtë buxhet, bashkarisht, e kanë hargjuar ish-kryetari dhe ky i tashmi. Edhe pse kryetari e dha përmbledhjen dhe sqarime për mjetet e hargjuara, obligimi i ynë është që të bëjm vërejtje për të kërkuar sqarime për aty ku kemi në dyshime reth buxhetit. Kryetari dha sqarime për hargjimin e buxhetit i cili ishte reth 8 milionë euro e ne duhet të kërkojmë sqarime reth kategorive të shpenzuara. Në fq. 4 të burimet nga mjetet e obligimeve kemi shumë prej 14 mijë eurove e në anën tjetër theksohet se komuna nuk ka marr huazime, por që ka borgje për furnizimet mjekësore, apo në faqen tjetër të "paisjet speciale mendicinalë" janë investime kapitale? Në fq.6 theksohet se komuna e ka borgjin prej 24 mijë euro e në fq.4 se nuk ka borgj e cilat janë këtu të vërtetat, apo sqarimet? Në fq.9 të niveli i pagës mesatare 108 mijë euro, janë paguar delegatët e Kuvendit dhe atyre punëtorëve me kontrata dhe dijmë se jemi në 27 delegatë dhe parashtrohet

pyetja se sa punëtorë janë me kontrata e kjo të na ishte sjell me shkrim? Te fq.10 shpenzimet e mallërave e shërbimeve, kemi shpenzime enorme për udhëtime në vend dhe jasht dhe aty kemi shumë prej 20 mijë eurove, paisjet tjera 11 mijë euro dhe shpenzimet për material higjienik-13 mijë euro, pastaj ndreçja e mirëmbajtja e automjeteve 28 mijë euro, drekat zyrtare 10 mijë euro dhe ato për vendime gjyqësore-5 mijë euro, si të spjegohen këto çështje. Në fq.12 shërbimet kontraktuese reth 16 mijë euro, çka paraqet kjo shumë, jemi të shqetësuar edhe reth shpenzimeve të materialeve të zyreve që janë afro 50 mijë euro e që janë reth 10 mijë euro më shumë se në vitin paraprak, apo 15 mijë euro më shumë se në vitin 2015. Nafta për nxemje qendrore është afro 140 mijë euro e në vitin paraprak ka qenë 76 mijë euro dhe, pse ky dalim kaq i madh? Karburantet për vetura reth 68 mijë euro e në vitin paraprak 54 mijë euro, që paraqet prap shtim të shpanzimeve. Dëshiroj të bëj një krahasim tjetër me vitin 2015, kur kemi pasur 27 mijë për mirëmbajtjen e automjeteve e shumë, e njëj e kemi edhe në këtë? Prandaj, nëse tani i llogarisim, për 3 viteve. Në fq.19 që kanë kaluar kemi pasur reth 87 mijë euro dhe e paes kryetarin se nëse qenka bërë këto shpenzime për 3 vite theksdoj se me këtë shumë kemi mundur të blejmë vetura të reja. Në fq.13 te shpenzimet komunale kemi shtim të shumë për 9 mijë euro e që do të thotë se kemi shtim të shpenzimeve të energjisë te kodi 132 10. Në fq.14 subvencionet dhe transferet kemi shtim të subvencioneve e që është për lavdatë e kjo shumë është 10 mijë euro, apo ndoshta ka qenë shtim, për shkak të vitit zgjedhor. Për këtë, në sencën e kaluar, kam kërkuar që të na dërgohet Lista e subvencioneve në mënyrë që të shtohet transparenca në Komunën tonë. Në fq.15 shpenzimet për investime kapitale të na jept mundësia te kodi 135 10, mirëmbajtja e investimeve duke pasur parasysh se vitin e kaluar ka pasur një shumë prej 90 mijë euro, si dhe dëshiroj të pyes lidhur me kodin 31 660 lidhur me “paisjet speciale medicinale” në shumë prej 11 mijë euro dhe do të ishte mirë që personat zyrtar të na japin sqarime, se si ka ardhur deri te shtimi i këtyre mjeteve për shëndetësi. Në fq.16 në formë të shkruar është dhënë sqarimi lidhur me investimet kapitale të cilat, në tërësi, kanë arritur shumë prej 3 milionë eurove, kurse nga shuma janë shpenzuar afro 1,7 milionë euro e 1,3 milionë euro kanë ngel të pashpenzuara? Dëshirojm të dihet se pse ka ngelur e pa shpenzuar kjo shumë e madhe kur dihet se mjetet që arrijnë përmes Granit do të këthenen në suficit, kurse arto vetanake do të kemi mundësi t’i përcjellim në këtë vit. Te fq.17 ekziston pjesa tabelare ku janë bërë krahasimet e viteve 2015 e 2017 e ku thuhet se në vitin 2015 kemi pasur 2 milionë euro për investime kapitale kemi rënie, që në vitin 2017 rënia e tyre është për 1.7 milion euro. Në fq.19 te nr.6 taksat për çertifikata të lindjes kemi dallim enorm në krahasim me vitin paraprak ku kishte 16.500 e në vitin 2017 reth 900 dhe pse kemi inkasim kaq të dobët të këtyre mjeteve?! Në fq.18 dënimet në trafik dhe te fq.20 reth inkasimit të mjeteve kemi shumë prej 887 mijë euro që do të thotë se nga bizneset komuna e jonë është dashur të grumbullon 680 mijë euro dhe 200 mijë në emër të qirave, që do të thotë se komuna nuk i ka inkasuar mjetet e që del se këto biznese qe një kohë të gjatë janë borgjlinjë të Komunës, apo që në tërësi, nga këto kategori, komuna është dashur të inkason 1,7 milionë euro e qështë inkasuar shuma e paraqitur në Raport dhe atë afro 1,3 milionë euro, e po të ishte paguar kjo shumë komuna do të kishte më shumë investime kapitale reth 1 milionë euro. Në fq.32 te SHM “Ruzhdi Berisha” më intereson fillimisht se a ka kjo shkollë veturë

, e nëse jo, pse aty figurojnë shpenzimet prej 7 mijë eurove dhe 3 mijë euro dreka zyrtare e nga u bënë këto shpenzime?!

z.Laurat Krasnigi- Edhe unë dëshiroj të shprehi shqetësime lidhur me dy kategoritë buxhetore e njëra nga ato është nafta për nxemje qendrore e cila vitin e kaluar ishte reth 76 mijë euro, kurse në vitin 2017 -146 mijë euro që do të thotë rritje enorme e shpenzimeve prej 92%. Më konkretisht, vetëm për naftë, përfshi edhe automjetet, komuna e Dragashit ka hargjuar 217 mijë euro, apo mesatarisht 875 euro për një ditë, që paraqet çmim të lartë për kapacitetet që ka komuna jonë. Po ashtu, ky Raport Financiar që na keni sjell për muajin janar, mua më ra në sy një kategori buxhetore është e kjo është akomodimi i zyrtarëve komunal në vend në shumë prej 2 mijë euro e më interson se si ka ndodhur për një muaj, dhe athu ndonjë delegacion komunal ka marr pjesë në ndonjë takim aq të rëndësishëm, pasi se për për në Kosovë kjo shumë është e pa pranueshme?! Gjithashtu, kam për të theksuar edhe një çështje për vitin 2015 se komuna ka blerë vaj dhe për çfar vaji është fjala se athu me atë vaj mos është gatuar apo qenkan përgatitur petulla?! Dhe, nëse diçka keni gatuar, do të kishte qenë të na ftonit, që pra kërkoj sqarime?!

z.Refik Latifi- Para se të filloj diskutimin për pikën e 3-të të bartjes së mjeteve të pa shpenzura të vitit 2017 në vitin 2018, kërkoj nga kryetari të na sqaron se si është e mundur se, një komunë e varfër si e jona, të lenë aq mjete të pa shpenzuara dhe si është e mundur, apo ndoshta nuk keni dijtur se si t'i shfrytëzoni dhe, është mëkat, pse nuk i keni pyetur qytetarët të cilët do t'u kishin ndihëmuar, që mendoj se shpërndarja e paraparë e tyre nga viti 2017 në vitin 2018 nuk është adekuate dhe në harmoni me nevojat e qytetarëve. Nga 89 mijë euro, për mallëra e shërbime, vetëm për Zyrën e Kryetarit, po ndahen 30 mijë euro e për shëndetësi vetëm 6 mijë euro dhe athua gjendja e shëndetësisë në komunën tonë qenka as e mirë e nuk paska nevojë për mjete shtesë e këtë më së miri e dijnë qytetarët e ne, këtu në sallë, se në çfar gjendje është kjo lëmi. E dyta-30 mijë euro ndahen për kompensimin e vendimeve gjyqësore e për lëmin e kulturës ndahen 800.....euro???? e kjo tregon se sa ne si Komunë po kujdesemi për kulturën, rininë dhe sportin dhe, në fund, po theksoj se asnjë cent nuk parashihet të ndahet për bujqësinë e që po dëshmon se ne nuk paskemi nevojë për të përkrahur ate e po jetojkemi në ujëdhesa e kjo është e pamundur?! Prandaj, kërkoj nga Ju, si kryesues, që të shkohet në votim e të merren parasysht të gjitha këto vërejtje që u cekën, por po i them kryetarit se ky Raport, siç na është sjell këtu, mos të merret parasysht e të përkrahet, pasi se vota ime do të jetë “kundër”?!

z.Nexhat Isufi- Kuvendi gjithnjë duhet të merret me të dalat dhe të hyrat buxhetore dhe destinimin e tyre. Pra, ku orjentohe shpenzimet, jo për shkak të prapavive politike dhe dëshirave që dikujt t'i mundësohet dhe mendoj se të gjithë ne që jemi këtu duhet të japim kontributin tonë se si do të orjentohe mjetet buxhetoore. Qe 2 vite po merremi me mjetete e pa shpenzuara e sidomos sivjet iu vu “kapaku”, nga se 50% e buxhetit tonë u rikthye në buxhetin e Kosovës e madje ka pasur mendime se paska shkuar në Serbi, edhe pse nuk është ashtu, por parashetrohet pyetja pse mjetet

tona të përfundojnë diku në Malishevë e mos të ngelin në komunën tonë?! Ne jemi ata të cilët japim rekomandimet më të mira, duke bashkëpunuar me ekzekutivin e që buxhetiti të hargjohet 0:0 e mos të këthehet në suficit dhe se, në vend që të kërkojmë mjete shtesë nga Qeveria e Kosovës për realizim të projekteve të caktuar, ne po merremi me mos shfrytëzimin e mjeteve të investimeve kapitale e që vitin e klauar kanë qenë diku 530 mijë euro, kurse, nga të hyrat vetanake në vitin 2017, nuk janë hargjuar 300 mijë euro nga viti 2016 e të bartura në vitin 2017 apo afro 50% të mjeteve nuk janë shpenzuar?! Në anën tjetër, mos të flitet për të hyrat e vitit 2017, pasi se me projekt kemi atë ujësjellësin gjigant me të cilin do të furnizohen shumica e fshatrave tona dhe nga këto arsye projektet po na kthehen e nuk po realizohen. Ku qëndron këtu zgjidhja e kësaj problematike e mos realizimit të projekteve tona e ne nuk po mund t'i realizojmë mjetete tona në dispozicion? Për këtë tenderuesit kanë të drejtat e tyre e ato janë 15 ditët e konkurimit e ju z.kryetar duhet, me këshilltarët tuaj e me ne bashkarisht, të kërkonit më shumë mjete shtesë që planifikimi i sivjetëm i mjeteve të realizohet, s'paku, 80% e jo mjetet të na kthehen në suficit. Me mjetet prej 1.2 milionë eurove, ne sot, kemi mundur të asfaltojmë apo kubëzojmë shumë rrugë e ne mos t'i ndihëmojmë pushtetit qendror, por qytetarëve tonë. Të gjithë, ne delegatët, kemi mendimet tona e ne duhet të gjejmë esencën e diskutimeve tona dhe dëshiroj t'i parashtoj një pyetje që nuk po e kuptoj unë-drejtorit të Financave në fq.16 ku thuhet se të hyrat vetanake nga fondet 21 e 22 nuk u realizua shuma prej 808 mijë eurove e për bartje kemi 630 mijë euro? Po ashtu, psh.për Zyrën e Kryetarit pse të parashihen mjete, pasi se ajo ka pasur mjetete e destinuar për vitin 2017. Edhe një çështje që nuk po e kuptoj janë në fq.13 shuma e pa shpenzuar për mallëra e shërbime e, për mua, mallëra e shërbime janë letra, lapsat, mobilje etj. e po barten 203 mijë euro, pse? Kur po dëgjojmë se komunat tjera se, jo vetëm që nuk po këthejnë mjete, por po kërkojnë, e ne ndoshta ka nevojë të përmbushim disa obligime të projekteve nga viti 2017. Pra, ne delegatët të japim rekomandime dhe mos t'i shikojmë gjërat bardhë-zi, por të bëjmë përmirësime që ato jo të bardha e këtu përgjegjësia më e madh i takon kryetarit me ekzekutivin e Komunës dhe, si duket, po jetohet vetëm për një çështje-që të jemi delegatë, apo drejtorë e të vendosim kravatat dhe njëërën dorë në xhep?! Psh.drejtori i Shëndetësisë duhet të dij se mjeku lëshon dokumente të sistemit shëndetësor të Kosovës, apo, në të njëjtën zyrë, po lëshohen edhe dokumente të "Komunës së Gorës"?! Unë për këtë po theksoj se kam dëshmi me dokumente të protokoluara e për këtë është i obliguar drejtori i cili menaxhon punën. Mjekëve të tillë duhet t'u tërhiqet vërejtja, pasi se ai mjek e merr pagën e Kosovës dhe po lëshon dokumente edhe të "Komunës së Gorës"?! Për mua kjo është tejet absurde dhe drejtori duhet t'a dinë se pacineti ka shkuar në QMF-në e Bresanës në orën 14,08 minuta e atje nuk ka snjë mjek e këto janë brenga të qytetarëve dhe janë obligime të delegatëve që t'i theksojnë?! Pra, të ngritim vetëdijen tonë edhe mikut e armikut t'i themi ate çka është e mirë e çka e keqe. Këshu pacienti po jetë i detyruar të përcillet që pa vetëdije, pa mjek-që ia lëshon udhëzimin e pa teknik - që do t'a përciell, që pastaj pacienti të vdes e pastaj të ngriten aktakuza e që përgjegjësit të dënohen, pasi se në vend që të jep ndihmën mjeku po detyrohet që këtë t'a bënë tekniku pa mjekun?! Për kto gjëra ne duhet tlë japim maksimumin dhe psh.çështjen e hapur të

ujësjellësit të zgjidhim sivjet dhe me u mbyll kjo problematikë, apo t'i vendoset mjete shpërthes atij rezervoari ku po lëvizin mijët e qytetarët nuk po kanë ujë?!

z.Velid Haxhisin- Ne e kemi para nesh një Raport më detal financiar se sa më herët, pasi se unë, si delegat i vjetër, kam pasur rastin të lexoj raporte më të mangëta se ky tani, pasi se, kur e kemi raportin më të gjerë, na hapet mundësia për diskutuar më shumë. Diskutimet janë të mirëseardhura dhe vërerjtjet e kolegëve janë me vend. Shqetësimi është i arsyeshëm lidhur me këthimin e mjeteve në suficit, si dhe shtimi i hargjimeve nëpër disa pozicione, që besoj se kryetari me stafin e tij do të ofrojnë përgjigje, për këto vërejtje? Unë mund të kuptoj se të gjithë drejtorët janë të rinjë dhe se shpenzimet mund të janë racionale, por nuk është kursim atëherë kur është dashur të hargjohet, por që duhet të janë të arsyeshme e ne, në Raport, mund të hasim në gabime teknike. Kolegu përmes facebookut e ka hasur një gabim prej 18 centëve, që është në regull, por ajo bie mbi ndërgjegjen e hartuesit të dokumenteve. Pra, ka shpenzime enorme dhe, si modele të raporteve, shfrytëzohen raportet e mëhershme, por që duhet pasur kujdes në mos përsëritjen e gabimeve e gabime mund të ketë edhe gjatë përkthimeve, nga raporti burimor dhe ai që përkthehet.

z.Zaim Hajredini- Është mirë se Raporti ka më shumë sqarime se sa të mëparshmit dhe është më i elaboruar se tjerët. Për çështjet e paqarta do të parashtrij pyetjet dhe do të shprehi shqetësime lidhur me mjetet e pa shfrytëzuara të vitit 2017 dhe se, 2 vitet e fundit, nuk po kanë ecuri lidhur me shpenzimet. Ka pasur kritika dher se di se a janë ato të ndikuara politikisht, pasi se vitin e klauar kishim zgjidhjet lokale dhe se partitë kanë hargjuar më shumë se zakonisht. Prandaj, kërkoj që këtë vit të kemi bashkëpunim më të mirë dhe kujdes për të pasur rezultate më të mira e këtu shpresoj se kontributin e vetë do t'a jap ekzekutivi i Komunës. Viteve të mëhershëm, ne si delegatë, shpesh-herë, jemi vu para aktitit të kryer, pasi se gushtin e kishim pushim e në shtator nuk kishim mundësi intervenimi e kjo supozoj mos të ngjan sivjet? Problemi më i madh ka qenë në mos ekzisimin e projekteve dhe se këtu dimëri është i gjatë (prill-tetor) e, gjatë verës, nuk po mund të realizohen projektet dhe se nuk po ka mundësi të përsëritjes së tenderëve, që e lus kryetarin që, sivjet, të fillohet më herët me realizimin e tyre. Disa çështje të caktura u përmendën nga kolegët-parafolës e unë kërkoj sqarime lidhur me ngarkesat e Komunës? Në fq.7 është shuma 49 mijë euro që janë shërbimet kontraktuese e që kërkoj sqarime nga komptentët? Në fq.8 mirëmbajtja e investimeve-85 mijë euro e në të njejtën faqe i kemi edhe entitetet publike në shumë prej 18 mijë euro, që kërkoj përgjigje nga kompetentët? Në fq.9 fllitiet për ujësjellësin dhe nevoitet, po shtu, përgjigja nga kompetentët se der ku është arritur dhe, nëse ka nevojë, edhe ne, si delegatë, do të japim kontributin tonë, në mënyrë që ky projekt kapital të realizohet sa më parë. Nëse nevoitet që të sigurohen mjete-shtesë, kjo çështje të zgjidhet, vetëm e vetëm, që të vjen te realizimi i këtij projekti, por që mos të na përsëritet prap këthimi i mjeteve në suficit e po flas për ato mjete nga Granti Qeveritar e që nuk mund të na këthehen, kurse ato vetanake mund të përcillen në vitin vijues. Pres nga kryetari i Komunës që të na ofron përgjigje reth bartjes së mjeteve në këtë vit dhe të dihet se ku ka pengesa dhe ku qëndron problemi-në ministri dhe shërbimet e tyre, apo në vetë komunitetin. Kam një pyetje sa u përket mbeturinave e këtu kemi

shpenzime prej 50% më të vogëla se në vitin paraprak dhe a ekziston ndonjë problem pse gjendja është kështu, pasi se, vitin e kaluar, për këtë kategori është shpenzuar afro 32 mijë euro e, këtë vit, diku 16 mijë euro? Po ashtu, në fq.16 përsëritet mirëmbajtja e investimeve e që, me gjasë, është kategori e cila përsëritet nga ajo që ishte më lartë e që befason? Është e vërtetë se pagesat për dënime në trafik janë më të larta për 200% dhe s'di se ku qëndron problemi, por është evidente se kemi të bëjmë me shtim enorm të tyre. Gjithashtu, edhe unë do përmendja rastin e SHM te kategoria e mirëmbajtjes së automjeteve e për çfar veture është fjala, kur dihet se atje nuk kemi vetur, apo, ndoshta, në pyetje është autobusi i cili shfrytëzohet për nxënës?

z.Vehbi Nazifi- I dëgjova me vemendje kolegët dhe vërejtjet e tyre që ishin me vend dhe nuk jam këtu për të mbrojtur autorin e raportit, por mund të them se ai ka hartuar një Raport të mirë. Këtu, gjithçka është transparente dhe do të kërkoja nga ai që të vazhdon tempon e këtill të punës. Po theksoj se, ne si delegatë, nuk jemi këtu që të bëjmë vetëm vërejtje, pasi se, ndonjëherë, nuk jemi eksperta për disa vërjtje të dhëna e që, pos vërejtjeve, duhet të japim edhe rekomandime për çështje të caktuara, për të dal nga kjo situatë e cila po na përsëritet, nga viti në vit, dhe mjetet po na këthehen në suficit? Edhe unë, personalisht, dal me rekomandimin që të jap vërejtje lidhur me investimet kapitale dhe i rekomandoj kryetarit të Komunës, dhe të gjithë atyre që merren me hartimin e propozim-projekteve, që të bëjnë kontrollimin e punimeve të projekteve që realizohen e ne këtu nuk jemi inxhinier e që kërkoj nga kryetari të punësohen nja 2 inxhinier, me kontratë mbi veprën, lidhur me kontrollimin e kompanive që i kryejnë punimet në projekte? Problemi qëndron se punët, pos që nuk po kryhen në tërësi, nuk po kryhen edhe si duhet. Për këtë, po jemi të detyruar që projektet e realizuar më parë, po duhet të korigjohen me intervenime shtesë, në vend që ne të realizojmë projekte të reja investuese. Me këto çështje, unë si delegat dhe ju jemi lodhur, në vend që të realizojmë projekte të reja me rrugë kah bjeshkët tona, apo me punët reth përfundimit të kanalizimit e që, vërtetë, duhet të punësohen, me kontrata, 2 inxhinier për mbikçyrjen e cilësisë së projekteve, sepse ne po ballafaqohemi me vërejtjet e qytetarëve të cilët problemet i adresojnë kah ne, si të zgjedhurit e tyre, ndajnë mjetet për projektet investuese, siç kemi vendosur vjet për për ndërtimin e rrugës në f.Rapçë e sivjet, prap, po duhet të ndajmë 10 mijë euro për të njejtën urë e për këto gjëra dikush duhet të përgjigjet. Njejtë është edhe me kanalizimin në f.Zaplluxhe ku kemi paraparë mjetet e ai nuk është funksional?! Nuk është me rëndësi kush i realizon këto projekte dhe cila parti është në pushtet, me rëndësi është të fillohet me ndëshkime dhe ne, si Kuvend, mjafton që të japim rekomandime që një firmë, e cila nuk ka kapacitete për të ofruar cilësi të punime, mos të angazhohet në projekte. Nëse është nevoja, një firmë të merr vetëm 2 projekte, por ata t'i realizon, siç duhet, pasi se disa firma po marrin shumë projekte e nuk po kanë kapacitete për t'i realizuar e po ngec realizimi i projekteve të kontraktuar e për këtë mjetet po na këthehen, apo po realizohen mjaft dobët.

z.Rexhep Kamberi- Kam vërejtur se Raporti është detal, pasi se qartë përshkruar shpenzimin e mjeteve, por, sikurse edhe parafolësit, mua më brengos sificiti dhe unë jam ithtar që buxhetit të ketë deficit, duke hargjuar të gjitha mjetet e jo që ato të shkojnë në sificit e pastaj paraqiten probleme për

Komunën. Unë, gjithësesi, do të votoj për këtë Raport dhe, sikurse dhe parafolësi, i cili përmendi shumë e shpenzimeve komunale prej 32 mijë eurove, e që janë hargjuar 16 mijë euro e pjesa tjetër është këthyer, unë, në senacën e kaluar, kam theksuar problemin e prronit të ne-Vraniç i cili duhet të futet në gypa, që pra konsideroj se mjetet e tilla mund të shfrytëzohen për projekte, si ky. Ky ishte vetëm një sugjerim i imi, pasi se administrata e re e kryetarit që po merret me këto punë, 3-4 muajt e fundit, ende nuk ka pasur mundësi serioze manevruese për të hargjuar mjete dhe i sugjeroj kryetarit që, në të ardhmen, ne me propozime, dhe ekzekutivi me veprime, të pamundësojmë këthimin e mjeteve në suficit buxhetor. Jam ihtar i asaj që Komuna të ketë obligime e mos të këthehen mjetet në suficitin buxhetor të Qeverisë së Kosovës, nga arsyeja se jemi komune e varfër dhe se kemi në mori problemesh që kërkojnë zgjidhje.

z.Selman Osmani- Buxheti i vitit 2017 është çështje e përfunduar dhe po theksoj se Raporti është gjithpërfshirës, edhe spe ka disa mangësi, por që sugjerimet që theksuan kolegët-parafoles, të shërbejnë si shemull për hartimin e buxhetit të vitit të ardhshëm. Ne nuk duhet të ndalemi dhe të analizojmë diçka që tash më është hargjuar, pasi se ne jemi tani këtu të ri dhe nuk e dijmë se si e kanë shpenzuar ata para nësh buxhetin. Me këtë rast, do të isha ndalur në disa çështje si spha të pozicioni “pajse speciale-medicinale” në shumë prej 117 mijë euroe kjo të jetë pyetje për drejtorin e DSHëndetësisë apo Kryetarin, pasi se është një shumë e lartë?! Po ashtu, nuk e kam të qartë “anëtarësimi në Odën e Infermierëve të Kosovës”, se për çfarë anëtarësie qenka fjala që paguan komuna jonë, pastaj shpenzimet e udhëtimit në vend dhe jasht, në shumë prej mbi 6 mijë eurove, dhe athua ata persona kanë qenë në Karibe apo ku kanë qenë?! Nuk kam pyetje tjera dhe do t’a përkrahim këtë Raport buxhetor, ne si JGP, dhe këto diskutime të shërbejnë si shembull i mirë për krijimin e buxhetit të ri-2019 e që do të kemi atëherë më shumë hapësirë për të analizuar disa çështje.

z.Valon Shabani (drejtor i DEF-ve)- Unë këtë Raport, në bashkëpunim me ZLFinanciar e kemi përgatitur në mënyrën më të mirë të mundëshme profesionale dhe nuk kemi fshehur asnjë shpenzim, apo të shtojmë ndonjë kategori. Disa delegatë, që kanë qenë edhe më herët në Kuvend, e dijnë se ky Raport është vetëm për Kuvend, kurse ai që i dërgohet MEF-it është edhe diçka tjetër e i cili nuk është kaq i kuptueshëm, siç e kemi përgatitur për Kuvend - të thjesht dhe që jep përgjigje të duhura. Disa nga pyetjet që i kam shënuar, do të mundohem t’i sqaroj. Shumica nga ju është e interesuar për ngarkesat e kjo është e përfshirë edhe në fre-balance e ajo është një konstatim i dhënë edhe nga Ministri se komuna e jonë nuk është e ngarkuar. Këtë Ministria e ka pasur parasysh dhe na i ka falur borgjet. Kategoria tjetër, në shumë prej 24 mijë eurove, është ajo që është shfrytëzuar, kurse të kolona e 4-të keni mënyrën e shfrytëzimit. Pra, ajo që është me rëndësi të dihet është se Komuna nuk ka shfrytëzuar kurrfarë borgji dhe për këtë nuk ka kurrfarë obligime. Njëra nga pyetjet ka qenë edhe ajo lidhur me “pajset speciale medicinale” në shumë prej 117 mijë eurove e këtë mun t’u dëshmoj përmes fre-balancit e ky është sistemi në të cilin nuk kemi ndërhy as ne e as nuk mundeni ju e që aty shënimet janë të tilla. Sa i përket kësaj kategorie në fq.1, ku përmenden 900,00 euro, kanë ngelur edhe 1 mijë euro e që është në fq.2 e ku kemi 39 mijë euro e që janë përgatitur për shfrytëzim e te

kolona 4 kemi 36 mijë euro, që do të thotë se, nga 39 mijë euro, janë shpenzuar 36 mijë euro e 20 mijë të tjera shtesë të pa shpenzuara e, në anën tjetër, kemi donacionin e Qeverisë Japoneze në shumë prej 70 mijë eurove që pra të gjitha ato mjete janë shfrytëzuar në tërësi prej 117 mijë euro. Ka pasur pyetje edhe lidhur me karburantet të automjeteve e unë mund të përmendi institucionet që i kanë hargjuar ato e këtu nuk janë shpenzime të 1 dite por të 1 viti ku hynë nxemja qendrore e institucione, siç janë: Komuna, SHM “Ruzhdi Berisha”, QKMF-ja në Dragasj dhe ato të QMF-ve në Bresanë dhe Llopushnik, si dhe Shërbimi i Zjarrfikësve. Ndërkaq për karburantet e veturave, ato më së shumti janë të Komunës, duke e pasur parasysh se ato shfrytëzohen e pastaj edhe drejtoratet e shërbimet tjera që posedojnë automjete, duke filluar nga Seksioni i Pylltarisë, transporti i personave për hemo-dializë, transporti i nxënësve nga komuniteti shumicë e jo shumicë, kurse, siç dihet, Komuna u ofron transport edhe KF-ke si “Opoja” dhe 2 klubeve tjera që janë të themeluar në Komunën tonë. Një nga kategori të për të cilën kërkua sqarime ishte edhe ajo e “shërbimeve të kontraktuara” e këtu bëjnë pjesë 6 punëtorët që janë me kontrata për pastrimin e borës, shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve, nga 3 paga për punëtorët e pensionuar të arsimit, si dhe një smundje e kafshëve-gungore për të cilat është paguar shuma prej 20 mijë eurove. Në vazhdim, kermi edhe shpenzimet e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve dhe shesheve në Komunë. Delegati i “Vetëvendosjes” ka parashtruar pyetjen lidhur me vajin e shpenzuar, apo shpenzimet për blerjen e tij e këto nuk janë vajra për ushqim por për automjete, kurse delegati i “Nismës” ato të shifrat e mjeteve të painkasuara vetanake-800 mijë euro, e që ishin paraparë vitin e kaluar, ne i kemi inkasuar 400 mijë e që pjesa tjetër mbetet si obligim. Vlen të përmendet se të mjetet vetanake-kategoria e investimeve kapitale është duke shkuar mirë dhe, në bisedë me zyrtarin e Zprokurimit, në procedurë të realizimit, janë 15 projekte dhe 30 të tjera në procedurë tenderimi, kurse është bërë hartimi i planifikimit të 60 projekteve tjera dhe e gjithë kjo nga koha prej kur kryetari aktual e ka marr mandatin.

z.Laurat Krasniqi- Unë fola me shifra relative e jo me vlera absolute. Që një kategori të të njejtës kategori buxhetore të shtohet 92% në aspektin ekonomik, nuk ka kurrfar logjike, dhe athu për të njejtën periudh kohore, shpenzimet të janë 92% mlë të larta dhe athua janë hapur shkolla të reja e nuk janë, apo dimëri ka zgjatur 8 muaj?! Athua ju keni arritur të zbuloni se ku ka shkuar nafta dhe kush po ua vjedh, unë e ne nuk e dijmë, sepse diku po ju rjedh-pikon e nuk po dihet?! Se, vërtet, diku po ju rjedh, do t’a kuptoni vetë kur të hartoni raporte tjera dhe ju po e merrni përgjegjësinë mbi vehte për institucionet që po e bëjnë keqpërdorimin, pasi se ka shpenzime të mëdha dhe mund të kuptohet hargjimi 30-40%, por kjo 92% është e pamundur?”

z.Valon Shabani- Para se të vijë në seancën të Kuvendit, unë kam biseduar me ZLFinanciar dhe Zyrën e Thesarit dhe, disa shifra, ndoshta, janë shqetësuese dhe unë po theksoj se po vij nga një parti politike-PDK, por që nuk e kam qëllimin të mbroj askend. Atë moment, kur të zbuloj për çfardo keqpërdorim të mjeteve publike, unë do t’a denoncoj personin e tillë, jo vetëm përmes Facebooka, por edhe në mënyrë legjitime. Unë po flasë në bazë të fakteve e jo në bazë të raportit të 4 zyrtarëve financiar dhe nëse ju, në anët tjetër, dyshoni në këtë procedurë, lirisht, mund të themeloni një

Komision dhe të shkoni tek zyrtarët financiar dhe të gjurmohen të gjitha faktet, duke pasur parasysh se ju jeni përfaqësues të popullit dhe çështjet të zgjidhen, siç duhet dhe ka hije. Në bazë të Raportit Financiar, të gjitha faturat janë në rregull dhe ju e dini se drejtori i Financave e Ekonomisë nuk është direkt përgjegjës për hargjimin e naftës në ndonjë institucion tjetër, kurse zyrtarët financiar janë të obliguar të veprojnë me pagesa, sipas faturave, dhe po theksoj se në Zyrën e Thesarit ekzistojnë të gjitha mundësitë për verifikimin e proceseve të pagesave, me faturat gjegjëse të paguara dhe të realizuara.

z.Samidin Xheladini- Drejtor, e keni të mjaftueshme atë se morët komplimentet nga ithtarët e partisë suaj këtu, por për realizim mos i arsyetoni askujt dhe se ju këtë mandat e keni marrë pastër dhe të jeni të kujdesshëm dhe mos i arsyetoni faturat e caktuara e këtë ua theksoj personalisht juve dhe për kryetarin, pasi se ne gjithnjë po bëjmë kritika, nga arsyeja se dëshirojmë të mirën dhe për këtë të jepem sugjerime dhe, bashkrisht me ne, duhet të veproni për t'u evituar dobësitë që po ngjajnë. Ky është Raport i shpenzimeve e ne këtu mund të flasim, ditë e natë, e asgjë nuk mund të ndryshojmë, pasi se këto janë mjete që janë shpenzuar. Por, gjithësesi, do të ishte më pak e dhembëshme nëse do të na jepeshin sqarime lidhur me shpenzimet e caktuara. Unë e mora përgjigjen adekuate reth karburanteve e automjeteve, pasi se, këtë vit ishin 146 mijë euro e vitin e kaluar 76 mijë euro dhe, te kategoria e mirëmbajtjes së automjeteve, kemi pasur 89 mijë euro shpenzime e kjo është një shumë e re e mjeteve e që paraqet shtim enorm, si dhe për materiale zyreje nga 30 mijë në 56 mijë euro. Po ashtu, te kategoria "shërbimet kontraktuese", çka paraqesin? Në fq.27 po theksoj se ju, si zyrtar i ri, do të ballafaqoheni me probleme lidhur me kategoritë që përmenden në fq.20, ku theksohet se u.d.Avokatit të Komunës ka njoftuar se, në proces, janë aktvendimet gjyqësore që duhet paraparë 248 mijë euro për oligimet në konteste e kjo do të thotë se, nëse ne nuk do të jemi të kujdesshëm, në procedura të ndryshme, siç janë tenderët etj., ne, vazhdimisht, do të paguajmë haraçin dikujt, duke i paguar shpenzimet me mjetet e obliguesëve tatimor dhe mos mendoni se ne jemi "opozitë destruktive", pasi se ne kujdesimi për ruajtjen e parasë publike, ndoshta, më shumë se sa ju të pushtetit?!

Kryetari- Krahas përgjigjeve të drejtorit, edhe unë do të mundohem të jap disa sqarime dhe, fillimisht, po theksoj qëllimet e mira të delegatëve se po përkujdesemi të gjithë për të mirën e parasë publike, sepse mendoj se diskutimet shkojnë në funksion të menaxhimit sa më të mirë të mjeteve dhe ato do t'i kuptoj si me qëllime të mira, si nga unë, po ashtu edhe nga zyrtarët që merren me këto çështje. Ne jemi mundur që të paraqesim Raport të mirë dhe sa më detal dhe, siç theksoi edhe drejtori, ky Raport dallon nga ai që i dërgohet MEF-it dhe si i tillë mundëson qasje në shpenzimet e bëra. Është e natyrshme se, kur është fjala për para, edhe diskutimet mund të janë më të nxehta e ne kemi 2 drejtime ku njëri është shfrytëzimi i parasë publike-siç duhet e i dyti-keqpërorimi i tyre e ne kemi mjaft shërbime që bëjnë pagesa dhe që janë përgjegjëse dhe do të isha i lumtur nëse ne organizohemi që ato të shfrytëzohen në mënyrën më adekuate të mundëshme e po të keqpërdor një zyrtar mjetet, ai nuk na shërben për të mirë as neve as vetvehtes, por që mund të theksoj se edhe

përkundër kritikave të dhëna, Komuna e jonë ballafaqohet me stabilitet financiar e, kur përmendet fjala e borgjit, ne nuk kemi borgje e fatura të pa paguara. Shumica e delegatëve paraqiti shqetësimet për suficit të mjeteve e që kjo ka ndodhë në të kaluarën e që do të mundohemi mos të ndodh, edhe pse shumçka varet nga procedurat të cilat nuk mund t'i diktojmë vetëm ne. Njëra nga porositë e arsyeshme ishte që zyrtarët financiar dhe, unë personalisht, të përkujdesemi për shpenzimin sa më racional të parasë publike. Ndërkaq, bartja e mjeteve ka të bëjë me faktin se në disa kategori kemi pasur mangësi të mjeteve e në disa nuk kanë mundur të realizohen me kohë për shkak të procedurave të ndryshme e që janë këthyer edhe në suficit, ndërsa, nga viti në vit, në mënyrë gjenerale kemi shtim të buxhetit dhe ideja është që buxheti të shpenzohet në mënyrë racionale, por që keqpërdorimet nuk i përkasin dhe as që njohin përkatësi partiake. Te shpenzimi i karburanteve, po them se këtë nuk mund t'a bëjnë 3 automjete, por siç theksoi edhe drejtori këtu hyjnë edhe shpenzimet transport të nxënësëve, pacientëve për hemo-dializë, klube sportive, e që ne i kemi përkrahur - me transport, kurse shoferi i cili angazhohet me autobus për ditët e vikendit e pas orarit merr mëditje prej 20 eurove e që këtë nuk mund t'a mohojmë. Nëse theksoni, që të zvogëlohen shpenzimet, këtë e kemi bërë dhe do t'a bëjmë, por kështu nuk duhet të reduktojmë nevojat e sanksionojmë klubet tona, kurse kur janë në pyetje OJQ-të këtë mun t'a bëjmë me arsyetime për mungesë të mjeteve. Nëse gjërat analizohen më thellë, nuk janë në pyetje vetëm veturat e Komunës e, nëse dyshoni, rastet mos i paraqitni vetëm te ne por direkt në Prokurori e gjykata-me emra e mbiemra pa u nguruar dhe fshehur askush. Subvencionet dhe transferet, jo që nuk janë shtuar, por kemi obligime edhe nga viti paraprak e që duhet gjetur mundësi për shtimin e tyre, nga se shtimi i tyre dhe nevojat e popullatës janë në rritje. Ne, me këto 23 mijë euro që kemi këtë vit, nuk mund të bëjmë subvencione për nevojtarët elementar e mos të flitet për subvencionime në bujqësi. Te mirëmbajtja e automjeteve, shumat janë të larta, por kur i keni parasysh automjetet tona, me autobus të vjetëruar dhe ato të Zjarrfikësëve po ashtu, kjo mund të kuptohet vetëvetiu. Mirëmbajtja e rrugëve në sezonin dimëror, ne në paisjet tona duhet të intervenojmë me nga 1 mijë euro shtesë e që, me sugjerimet tuaja, do të na ndihëmonit nëse do të hapnim tender për mirëmbajtjen e tyre, duke angazhuar firma private për pastrim nga bora, apo edhe transport të nxënësëve. Pra, më mirë të jepen mjete për këto çështje se sa të investohen më shumë se sa kushton shërbimi për to, për çdo vit. Kemi mjete të parapara për sufinansim në kulturë, sepse kemi donator potencial dhe e kemi paraparë shumë. Sa i përket ujësjellësit, kjo çështje ndërlidhet me qytetarët dhe unë e kam inicuar procedurën për vlerësim të projektit dhe jam i mendimit që kjo çështje të zgjidhet përmes gjyqit, ndaj punëkryesit. Mjerisht, neve po këthehen mjetet nga të hyrat vetanake 200-300 mijë euro, si dhe i humbin 20-30 mijë euro nga Granti i Qeverisë.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është miratimin e Raportit Vjetor Financiar-2017...? 17 “për”, 5 “kundër” dhe 1 votë e “përmbajtur”.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Në kuadër të kësaj pike tani e kemi shqyrtimin dhe miratimin e P/Vendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara vetanake të vitit 2017 në vitin 2018 e cila është praktikë e secilit vit, dhe, nëse keni diçka për të shtuar, hapim diskutimet...

z.Nexhat Isufi- Siç po shohim, edhe këtë vit kemi bartje të mjeteve, madje më shqetësuese, që kisha kërkuar nga anëtarët e komiteteve të dëgjoj se a kanë bërë ndonjë propozim për ndryshim, apo vetëm e kanë përcjellur në Kuvend? Kemi tabelën sipas fondeve dhe numrin e kodeve buxhetore e gjithnjë na është theksuar se mjetet e mbetura i orjentohej për vendosje Kuvendit e unë e kam lexuar LV Lokale dhe nuk kam hasur në diçka të tillë, kurse nuk pajtohem me këtë Tabelë këtu, nga arsyeja se ne duhet të kemi një buxhet minimal, e që do të hargjohej këtu 6 euro për shishe të ujit mineral? Edhe kjo sallë, për të cilën kemi folur vazhdimisht duhet të jetë sallë, si duhet, për delegat, takime tjera dhe për qytetarë-ashti siç i ka hije, pasi se çdo delegacion vjen dhe pranohet këtu e që ne duhet të ndajmë buxhet të mjaftueshëm për këtë. Pra, kjo sallë nuk i ngjan sallës së Kuvendit e ne, urgjentisht, duhet të ndajmë mjete, nga të hyrat vetanake, pasi se unë e kam paraparë ndryshe, që mos të dalim në foltore, por të diskutojmë nga vendi ku e kemi edhe materialin tonë. Rishikimin e buxhetit, vitin e kaluar, e kemi pasur, pak para skadimit të mandatit, dhe, ata që kanë qenë në KPFinanca, këtë e dijnë më së miri dhe atëherë kemi bërë korrigjime të caktuara buxhetore dhe unë kam qenë më i zëshmi dhe, në bashkëpunim me ZLFinanciar, kemi biseduar lidhur me sigurimin e kontejnerëve për mbeturina në qendër dhe nëpër fshatra, duke ndarë 10 mijë euro nga 5 mijë euro prej 2 kategorive buxhetore. Me këtë ka përfunduar puna e ish-qeverisë lokale dhe, nëse mendojmë për të mirën e qytetarëve, duhet bërë sigurimi dhe largimi i të vjetërve. Kjo nuk është për mua personalisht, por për mirëqne të qytetarëve për të siguruar ambiejt të mirë e të sigurt dhe pse mos të kemi të vendosur kontejnerë në parqe e sheshe si te Adem Jashari etj. Për këtë ekziston shkolla teknike “Ymer Prizreni” e cila, me çmim shumë të lirë, mund të bënë sigurimin e tyre e qytetarët theksojnë se ata që janë të ngarkuar me pastrim të bëjnë edhe sigurimin e kontejnerëve dhe pse psh.mos të heqen nga Zyra e Kryetarit 10 mijë euro. Kur i kemi ndarë mjetet vitin e kaluar, për këtë, kemi ndarë kaq mjete. Parashikimi për Zarën e Kuvendit-10 mijë euro janë pak dhe s’di se a është planifikuar në KPFinanca edhe vizita studimore e delegatëve me stafin, rinovimi i sallës apo çka do qoft tjetër? Te Administrata e Personeli-furnizimi me material zyreje janë paraparë 40 mijë euro e ne këto i kemi ndarë më herët? Nëse këto mjetet nuk janë hargjuar, pse ndahen prap mjete për këtë qëllim? Mos është në pyetje se është shtuar personeli i Administratës, apo diçka tjetër që kërkon kaq mjete dhe të heqen nga Administrata 15 mijë euro, kurse te Urbanizimi përmenden kompensimet për hargjime në konteste gjyqësore e psh.kur janë kontestet me tenderë ne nuk po kemi fuqin për t’i fituar ato dhe mendoj që këtu të heqen edhe 10 mijë euro? Te meremetimi i infrastrukturës rrugore, mendoj se 70 mijë euro janë pak, pasi se dijmë të gjithë se në shumë pjesë të rrugëve tona janë paraqitur gropat e ku është këtu MInfrastrukturës? Ndoshta edhe te sufinansimi me donatorë është planifikuar diçka, por që nuk është realizuar? Po ashtu, prap na paraqitet plaifikimi urban dhe hartimi i projekteve dhe ju lutem

mos e përmendni këtë kategori dhe inspektionin, pse? Rregulli ekonomik thekson se ai i cili punon duhet të shpërblehet e ai i cili nuk punon të ndëshkohet. Ne ende nuk kemi deponinë e ngurt, e unë e kam me koordinata të shënuar secilën deponi ilegale, që do të thotë se personi i caktuar e ka rrënuar shtëpinë e materialin e ngurt e ka hudhur-diku te ura, e kjo po ngjan si në f.Rapçë të cilën e kemi paparë të shpallet fshat ekologjik, pasi se të gjithë banorët e këtij fshati i paguajnë mbeturinat. Por, para një jave, unë e kam vizituar këtë fshat, dhe, kur shkova atje – te ura në hyrje të fshatit, pash deponin e mbeturinave të ngurta e çka po na bënë Inspekcioni i cili nuk po i ndëshkon kryesit e veprave të këtilla, pasi se ai i cili po e rrënon e ndot mjedisin jetësor duhet të ndëshkohet, sepse ndryshe nuk kuptojnë?! Pra, unë nuk jam që të ndahen këto mjete, sepse Inspekcioni nuk po e kryen punën e vetë. Për DKRSportin, vitin e kaluar janë ndarë 51 mijë euro për rinovimin e Shtëpisë së Kuluturës dhe unë edhe atyre do t'u heqsha 10 mijë euro, pasi se shumica e punimeve atje ka përfunduar. Pra, të nderuar kolegë, Lista për bartjene mjeteve duhet të definohet saktësisht e nuk kam hasur në LV Lokale bartjen e tyre, nga një pozicion në tjetrin, dhe të fillojmë të punojmë për qytetarët, kurse të gjithë ishim, unanim, që edhe kjo sallë të rregullohet.

z.Velid Haxhisin- Ky P/Vendim paraqet atë se ku do të shpenzohet mjetet e parapara dhe nuk e dijmë se kryetari me drejtorët e ka bërë konsulta me MEF-in se a mund të bëhet ndryshim lidhur me destinacionin e tyre, nga kodet e ndryshme buxhetore dhe nëse këtë nuk e ka bërë, tash më jemi vonuar që e kemi në rend dite? Unë do të orjentohej në një pozicion te nr.10 e ky është ndërtimi i urës te Rapça-kufi me Shqipërinë e janë paraparë 10 mijë euro dhe sa kam mundur unë të llogarisë kjo shumë është e mjaftueshme e 100-150 metrave asfalt, nëse mendohet në ndërtim të rrugëve. Nëse mendohet në ndërtim të rrugëve, këto mjete janë të vogëla e që tërheqi vemendjen te memremetimi i infrastrukturës te nr.8 ne e kemi pasur një projekt të përbashkët për rrugët e Restelicës e Kapres e që është dashur kubëzimi i rrugëve e që për Kapre mendoj se projekti ka përfunduar e mjetet në shumë prej 40 mijë eurove nuk janë realizuar e që është dashur të destinohen për f.Restelicë. Ne i kemi bërë matjet s' bashku me drejtorët dhe ato matje i kanë vërejtur qytetarët e ata tani po ndihen të mashtruar, pasi se mjetet nuk janë realizuar. Meqenëse fjala është për mjetet vetanake, është logjike që të shfrytëzohen për të njëjtin destinim. Por, nëse nuka ka mundësi të realizohen bashkarisht, apo dikush do të thoshte se unë jam lokalist, e ne para disa ditësh e kishim rrëshqitjen e dheut në Restelicë, pasi se sanimin e kemi problem atje e për disa projekte po nxirrej mjetet prej 30-40 mijë eurove për dofar "mure mbrojtëse", kurse vazhdimisht po flasim për rrezikun në rrugën Dragash-Resticë, sidomos nga Gllloboçica-Resticë e ne po sillemi duke mos investuar fare atje e që mendoj se duhet investuar?

z.Samidin Xheladini- Kryetari dhe ekzekutivi i Komunës, më së shumeti, duhet të orjentohej në zgjidhjen e problemeve me ujë, ku janë prioritetet, si dhe kanalizimet, rrugët e çështje tjera të infrastrukturës. Në anën tjetër, mendoj se duhet zvogëluar shpenzimet për mallëra e shërbime, në mënyrë që të gjithë qytetarët të shfrytëzojnë investimet kapitale. Më herët, kanë qenë të parapara disa rrugë që të asfaltohen nga pushteti qendror e që ishin të sigurua mjete në disa milionë euro e ne

nuk kemi informata se çka u bë me ato mjete dhe a do të sghfrytëzohen? Ato rrugët nuk u ndërtuan e na mbetet shpresa se ato mjete a do të shfrytëzohen. Ato rrugë kanë qenë në drejtim të Zaplluxhes, Restelicës. Po ashtu, është pritur edhe aktivizimi i Qerdhes së Fëmijëve në Dragash e që do t'le ishte mirë të jepeshin sqarime. Gjithashtu, nevoiten sqarime lidhur me ujësjellësin qendror pasi se janë hargjuar e pritet të hargjohen mjaft mjete. Ndërkaq, pasi se ka mjete të mbetura nga mallërat e shërbimet, do të ishte mirë që ato të orjentohej për realizim në investime kapitale? Kryetari, nënkryetari dhe kryesuesi janë nga fshati im-Bresana dhe, unë si delegat e që jam i vetëm në opozitë, por gjithsesi dëshiroj të di se a keni biseduar lidhur me rregullimin e urës në Bresanë e që është kërkesë urgjente e banorëve të kësaj ane. Do të kishte qenë mirë që, në fillim, kryetari të na kishte informuar se ku ka paraparë planifikimin e orjentimit të tyre për bartje?

z.Hajrudin Hoxha- Unë, shkurtimisht, do të ndërlidhem me z.Velid H. te pika 8 lidhur me ndërtimin e rrugëve e të ju informoj se në Restelicë kemi pasur rrëshqitjen e dheut e rruga nuk ka funksionuar 15 ditë rruga e duke i falënderuar kompanisë “Drini” dhe udhëheqësisë komuna disi u aftësua, por që gjendja nuk është e sanuar plotësisht dhe mos më kuptoni si lokalist. Prandaj, të lehet pak sa anash çështja e ujit që ka edhe zgjidhje tjera e rruga është me prioritet si nevojë qytetare, që kërkoj vendosjen e kësaj çështje për t’u votuar?

z.Munir Jonuzi- Mua më interson pika 10 e ndërtimit të rrugës, përkatësisht rinovimi i urës në Rapçë e që dihet se gjendja është e vështirë dhe se nevoitet sanim serioz i gjendjes. Atje duhet ndërtuar 2 mure mbrojtëse e të zgjidhet problemi, edhe pse shpejtë është intervenuar në te, mjerisht, prap, duhet të interevenohet. Për këtë, propozoj që shuma nga 10 të shtohet në 20 mijë euro e pastaj të vazhdohet me ndërtimin e rrugës, kah kufiri?

z.Zaim Hajredini- Edhe unë desha të përkujtoj se kryetari, në fillim, u dasht të jep sqarime se ku ka paraparë orjentimin e mjeteve për bartje, apo drejtori i Financave e pastaj të lëshohemi në diskutime, për të shkurtuar diskutimet reth kësaj çështjeje të P/Vendimit për bartje të mjeteve?

z.Vehbi Nazifi- Unë do të kisha kërkuar që kalohet në votim, pasi se, nëse vazhdojmë kështu, do të humbim shumë kohë e kur të kemi propozime nga fshatrat, ato të merren parasaysh me rastin e hartimit të buxhetit. Kam një vërejtje lidhur me urën në Rapçë dhe, nëse është në pyetje vetëm sanimi, mendoj se janë shumë 10 mijë euro e, nëse është ndërtimi nga fillimi, të shifet se sa do të kushtonte. Mendoj se shumica e parashikimeve për bartje është e planifikuar mirë e tani nuk mund në mënyrë individuale të kërkojmë investime. Nëse vazhdojmë ashtu, unë them se edhe rruga jonë e Kuklibegut nuk ka përfundur për në bjeshkë, por që nuk dëshiroj t’a theksoj se do të paraqiteshin edhe rastet e fshatrave tjera, që mendoj të miratojmë P/Vendimit, siç është paraparë?

z.Velid Haxhisin- Unë do të kërkoja replikë, pasi se gjendja në Restelicë është urgjente e për këtë ne kërkuam intervenime nga bartja e vjetme. Nëse kolegët mendojnë të kudërtën, mund të

vizitohet zona e cila bllokohet 2-3 ditë kur kemi reshje e, vitin e kaluar, nuk u shfrytëzuan 40 mijë euro nga mos angazhimi i drejtoratit gjegjës.

Kryetari- Ndoshta, është më mirë që, qysh në fillim, të marr fjalën dhe të jap sqarimet e caktuara, pasi se ky P/Vendim për bartjen e mjeteve nuk është i rastit e ne, paraparakisht, jemi konsultuar me MEF-in për të caktuar këto pozicione e për të hartuar parashikimet e reja me kode të reja. Duhet të dihet e këtë e kemi theksuar shpesh se, nga një kategori buxhetore, përkatësisht nga mallërat e shërbimet, nuk mund të bëhet bartja e mjeteve në ndonjë kategori tjetër. Mund të ngjanë bartja e mjeteve nga një drejtorat në tjetrin, por jo nga një kod ekonomik në kodin tjetër. Ne sot mund të votojmë edhe ndryshe, por MEF-i është kompetente për vendimin përfundimtar, duke pasur parasysh se mallërat e shërbimet janë kategori e nevojshme e funksionimit normal të secilit drejtorat. Një pjesë e projekteve janë miratuar vitine kaluar e tani paraqitet mos përfundimi i tyre e këto u theksuan në diskutimet e mëpartshme e që ka nevojë të paraqitet prap ato projekte për realizim e që mund të ceken edhe, veq e veq, kurse me Plan të Punës parashihet edhe vizita studimore e delegatëve, me diku 10 mijë mjete të nevojshme. Te kategoria e subvencioneve nevojitet bartje të mjeteve karrshi obligimeve dhe nevojave në rritje për to. Te Zyra e Kryetarit kemi kategorinë e mallërave e shërbimeve e duhet të dini se kjo nuk është vetëm për nevojat e kryetarit, por për shumë shërbime që janë të lidhura me Zyrën e kryetarit. E njejta gjë vlen edhe për Administratën apo Shëndetësinë. Sa i përket ujsjellësit qendror e keni parë se ekziston shuma e po theksoj se unë dhe kam pasur biseda me përfaqësues të MEF-it me të cilët jemi marr vesh për ndarjen e mjeteve të caktuara në kuptim të sufinancimit lidhur me sigurimin e kamionit për Zjarrfikësit e që ai do të jetë i punueshëm, por i ruajtur e me karakteristika për nevojat e kësaj lëmie të cilës i ka munguar deri tani, dhe se ju e dini faktin që nuk qëndrojmë mirë me paisjet e këtilla. Pra, ky kamionë është donacion për të cilin nevojitet sufinancimi, edhe nga ne. Unë mendoj se lidhur me këtë pozicion mund të kemi përkrahjen tuaj e të bëhet pagesa e nevojshme, pasi se me 12 mijë euro nuk mund të diskutohet se mund të sigurojmë kamion të tillë për Zjarrfikës edhe për pastrim të borës. Ne këtë e kemi shqyrtuar dhe në bashkëpunim me MEF-in jemi dakorduar që, nga pozicioni i ujsjellësit qendror të ndahen 15, përkatësisht 16 mijë euro, e kështu të jetë përfshirë shuma në Vendim tonë zyrtar. Në realitet, këto janë mjete vetanake dhe, nëse nuk realizohen, prap mund t'i kërtohen Komunës. Vendimet për ekspropriim përmes gjykatave, janë vendime për nevoja të ekspropriimit. Meremetimi i infrastrukturës rrugore janë mjete prej 70 mijë eurove e vitin e kaluar për to kishim 30 mijë euro e që ideja është të intervenohen në disa drejtime ku ka pasur fetkeqësi natyrore, siç ka qenë në: f.Brezne, Bresanë, pastaj ndërtimin e vend-pritjeve për stacione autobusësh dhe diçka që mund të ketë nevojë emergjente, në ndërkohë e që, pra, këto mjetet nuk janë paraparë rastësisht. Te sufinancimi i projekteve me donatorë paraqet atë se ne kemi kontakte me donatorë e disa marrvëshje janë nënshkruar e disa janë në pritje e nuk ka qenë keqë të ndahen mjete të caktuara. Ndërtimi i rrugës Rruga e Rapçës-Ura, që dikush e përmendi shumë prej 10 mijë eurove, mund të jetë e lartë e nëse jetë ashtu, nga ajo shumë mund të shfryrëtohet prap për çështje tjera, kurse ne e kemi paraparë që, në radhë të parë, të sanohet ura e pastaj meremetimi i rrugës. Nëse ju kujtohet, vitin e kaluar kemi ndarë 30 mijë euro e që ato me 10

mijë euro e tashme, nëse teprojnë, do të barten në infrastrukturë tjetër. Për meremetimin e Shtëpisë së Kulturës, vitin e kaluar, kemi parapartë 50 mijë euro e gjithsejtë janë të parapara 90 mijë euro e jemi në proces që, bashkarisht, me MKRS-në të gjejmë mundësi për sufinansim të këtij projekti e që kjo Shtëpi e Kulturës të jetë në funksionin që i përket. Sa u përket hartimit të projekteve, në pyetje janë mjetet për hartimin e projekteve për vitin ardhshëm-2019 e që, ndoshta, nuk kemi paraparë sa duhet, planifikojmë që, s'paku, projektet më të mëdha të përshkruajmë në atë mënyrë që të gjejmë ndonjë kompani për hartim profesional të projekteve dhe të shpejtojmë procedurën buxhetore. Te sufinansimi përmenden 7 mijë euro e ne kemi 30 mijë euro, nga gjithsejtë 37 mijë euro, e këtu presim bashkëpunim me donatorë potencial. Nuk dua të imponoj, por se te mallërat e shërbimet, po theksoj se aty nuk mund të bëhen ndryshime. Po përsëris se për kod të ri buxhetor, bashkarisht me MEF-in, do të realizojmë blerjen e kamionit të Zjarrfiksuesve nga pozicioni i ujësjellësit qendro, por me përkrahje nga Ju. Po ashtu, u fol për sallën e Kuvendit e ne për këtë kemi biseduar me donatorë, konkretisht me organizatën qeveritare Turke "Tika", e cila, ndoshta, do të merr parasysh propozimin tonë për rinovimin e sallës. Nëse ky projekt nuk do të ketë sukses, kjo mund të bëhet edhe përmes revidimit-rishikimit të buxhetit tonë. Sa i përket gjendjes në f.Restelicë ajo është alarmante e ne kemi vepruar në kuadër të mundësive tona reale dhe se, me kohë, i kemi alarmuar organet kompetente qendrore në Prishtinë. Problemi këtu qëndron se nuk mund të parashikohet se çka mund të ndodh, pasi se rreziku është konstant? Dhe nuk është problemi të parashihen psh.20 mijë euro për intervenime të caktuara, por çështja kërkon angazhman më të madh e, nëse do të dërgonim ndonjë perator ekonomik ashtu, do të krijonte më shumë dëme se dobi pa u analizuar mirë gjendja. Për këtë presim Raport Detal të cilin e ka premtuar MInfrastrukturës dhe, siç jeni në dijeni, nuk është në pyetje vetëm rrëshqitja e dheut, por e gurëve që paraqesin rrezik permanent për qytetarët. Sa i përket urës në f.Bresanë, siç e dini, kemi pasur një marrveshje me ministrinë kompetente e atëherë ata do të angazhohen për rinovim e që shpresoj të përfitojmë donacionin e mos të hargjojmë mjetete tona. Rruga për Zaplluxhe është problem projekt 3-vjeçar dhe vitin e kaluar përfundon ai projekt dhe, sipas informatave që kam, janë edhe 102 mijë euro për përfundimin e projektit. Sa i përket f.Restelicë është e paraparë të ndërtohet një mur mbrojtës, si dhe kemi paraparë meremetimin e rrugës për në Pllajnik-Xerrxe. Prandaj, ju kisha kërkuar që të përkrahëni këtë P/Vendim me këto ndryshime që u theksuan, siç thash me futjen e kodit të ri për blerjen e 1 kamioni për Shërbimin e Zjarrfikësëve.

z.Nexhat Isufi- T'i bashkangjitem kryetarit në diskutim se në bazë të asaj që theksoi mund të bëhen intervenime në këtë P/Vendim. Pra, rinovimi i sallës së Kuvendit mund të futet si projekt, nga mallërat e shërbimet. E dyta-kontejnerët që ishin premtuar, nga viti i kaluar, për shërbime më të mira komunale e kjo të realizohet nga mallërat e shërbimet, apo në forma tjera nga pozicioni i kryetarit dhe drejtorateve? Këtë e propozova për t'u ofruar ndonjë zgjidhje, edhe pse kërkesat që kemi nuk do të mbuloreshin edhe nëse i japim 1.2. milionë euro. Unë, plotësisht pajtohem për blerjen e 1 kamioni për zjarrfikës dhe se këto kërkesa, me ndryshime, mund të bëhen, duke kërkuar implementim nga ministria që ai kamion të sigurohet, si dhe 1 tjetër për bartje të mbeturinave, qoft edhe vitin tjetër? Ky kamion i propozuar mund të përfshihet edhe përmes sufinansimeve me donatorë. Ndërkaq, sa i

përket ujit, unë këtë problem do t'a zgjidhja edhe personalisht, duke siguruar nga një shishe edhe për delegatët e Kuvendit?

Kryetari- Sa i përket blerjes së kamionit për Zjarrfikës, kjo paraqet donacion, por deri në shkallën e duhur e me pjesëmarrjen tonë. Këtu hyjnë shpenzimet e transportit etj. kurse kontejnerët po ashtu i kemi të paraparë si sufinansim me donatorë dhe jemi duke punuar që të sigurohen diku 20 kontejnerë ,nga të cilët 10 do t'i paguajmë ne, që nevojett angazhimi i të gjithëve, kurse nga 1 shishe ujë do t'a keni në dispozicion, nga seanca e radhës?

z.Hajrudin Hoxha- Unë, z.kryetar, e dhash propozimin për ndryshim të P/Vendimit, por ju e keni vizionin tuaj se si do t'i orjenton këto mjete. E përshëndes blerjen e kamionit të Zjarrfikësve i cili është në shërbim të qytetarëve, por Restelica që Restelica ka përjetuar tragjedinë me humbje nejrëzish dhe dëme materiale dhe që është harruar nga Komuna dhe Qeveria e Kosovës e cila ka dhënë premtime, apo po presim të ndodhin tragjedi tjera e që, prap, të shkohet atje për t'u fotografuar në Facebook dhe rrjete sociale. Pra, në Restelicë zjarri është duke ndodhur e nuk i duhet kamioni i zjarrfikjes e që ajo është harruar nga viti 2013 e që mund të ndodh tragjedia në çdo moment e prap të harrohet?! Këtë që po e theksoj është serioze dhe nëse duhet të ndahen 50 mijë euro e këto nuk janë mjete të mëdha për Restelicën dhe banorët e saj dhe të parashihen mjete nga ato 70 mijë-50 mijë euro?

z.Shpetim Hajredini- Unë nuk do të ndërlihem në P/Vendimin për bartjen e mjeteve, pasi se nuk kam qenë anëtarë i Kuvendit i cili ka vendosur për buxhetine vitit paraprak dhe çka të deklarohem reth këtij P/Vendimi?. Unë dola në foltore të kërkoj që, ne delegat e rinjë të Kuvendit, të kemi të drejtën e qasjes në dokunetet zyrtare të vitit 2018 reth planifikimit të buxhetit.

z.Zaim Hajredini- Tani është më lehtë të flasim, pas paraqitjes së kryetarit me sqarime reth P/Vendimit dhe unë e përkrahi këtë e ku u përmen ndryshimi me blerjen e kamionit për Zjarrfikësit, e unë angazhohem që të parashihen edhe mjete shtesë për aftësimin kamionëve tjerë në parkun e Zjarrfikësve, kurse sa i përket sigurimit të kontejnerëve, që i përmendi kolegu N.I. jam i gatshëm të jepet kontribiti ynë dhe unë e kam bërë një Kërkesë të tillë, pasi jemi në negociata për pjesmarrje me donatorin e tillë, që kjo gjendje është në të mirë të ambientit për t'u zgjidhur pozitivisht. Sa i përket çështjes së Restelicës, të gjithë jemi për përkrahje që të gjendet zgjidhje, por problemi po qëndron se nuk po parashihen me kohë mjetet për kategori të tilla dhe jam i mendimit që mos të lëshohemi në korigjim të kategorive, sepse kështu nuk do të shkojmë askund dhe seanca do të stërzgjatet?

Kryesuesi- Tani kalojmë në votim, si do të votojmë në "paket", apo sipas prpozimit të kryetarit?

z.Velid Haxhisin- Më falni, por kryesuesi duhet të respekton procedurën. Ne e kemi një P/Vendim me materialin e seancës e kemi edhe mjaft propozime, siç kam propozuar unë dhe kolegët tjer e që, secilin propozim, duhet qitur në votim?! Këshu, si duhet, po dëshirohet të kalon ky material, pa propozimet që kanë dalë këtu?

z.Vehbi Nazifi- Ndoshta unë nuk jam personi adekuat për sqarime, por mendoj se gjërat janë të qarta, pasi se kryetari sqaroi të gjitha dhe, ne si GP-PDK dhe unë personalisht, jemi për përkrahjen e P/Vendimit e që ndryshime të ketë të blerja e kamionit për Zjarrfikës dhe sufinansimi me donatorë-70 mijë euro. Nëse nuk kalon propozimi i kryetarit, do të kalojmë në votimet, sipas propozimeve të dhëna?

z.Velid Haxhisin- Si duket nuk po kuptohemi se, nëse tani veheet në votim propozimi i kryetarit-me propozimin me kamion të Zjarrfikësve, unë nuk kam asgjë kundër atij kamioni, por do të jam i detyruar të jam kundër propozimit të kryetarit, pasi se propozimi i im nuk po merret parasysh? Sipas fjalëve të parafolësit, po flitet që vetëm propozimi i kryetarit të shkon për votim e kështu të përfundohet?

z.Zinaida Elmazi- Ju kisha lutur që për çështje tjera të pritet, pasi se gjendja në Restelicë është e rëndë ku ka probleme e mos të vijmë në situatën e vitit 2012.

z.Samidin Xheladini- Me sa e kuptova, kryetari e ka marr për obligim për t'u ndihmuar Restelica e ai dinë formën se si? Është evidente se Restelicën duhet ndihëmuar e ky nuk është obligim vetëm në Restelicë dhe se kryetari atë e ka kuptuar se kjo është prioritet. Ndërkaq, sa i përket urës së Bresanës, kryetari në paraqitjese vetë dha premtime se ky problem do të zgjidhet e, për këtë, jemi që ky P/vendim të përkrahet.

z.Sevim Avdullahi- Mendoj se gjërat nuk janë të qarta, pasi se kryetari theksoi se nga mallërat e shërbimet nuk mund të intervenohet? Nëse bëhen ndryshime kjo duhet të merret pyrasysh, si dhe ajo për shëndetësi ku për mallëra e shërbime parashihen vetëm 4 mijë euro. Po ashtu, z.Nexhat I. e përmendi rinovimin e sallës së Kuvendit dhe, nëse bëhen intervenime, duhet bërë intervenime komplete të dokumentit, apo vetëm për blerjen e kamionit të Zjarrfikësve dhe, nuk është se ne nuk jemi për atë kamion, por jam që kryetari, prap, të jap sqarime lidhur me miratimin e këtij Vendimi.

Kryetari- Unë dua të sqaroj se disa gjëra nuk varen nga dëshira ime apo e juaja apo Ministrit. MEF-i nuk lejon që kategoria e mallërave e shërbimeve të ndryshohet dhe ne, edhe nëse e votojmë ashtu atë Vendim, besoni se do të na këthehet. Që dikush të intervenon në këtë Vendim, në radhë të parë, duhet të respekton kodin ekonomik e ne këtë e bëm vetëm lidhur me sigurimin e kamionit. Për Restelicën, unë theksova se nuk është çështja se do të ndanimin 10 mijë euro dhe mund të merren edhe 10 ijë euro të tjera nga pozicioni i Rapçës për në Restelicë, por çka do të arrihet me atë? Siç theksuam, lidhur me gjendjen në Restelicë, ne kemi ftuar edhe ekspertët nga niveli qendror-njerëz profesionistë, gjeodet etj. të cilët do të japin mendimet e tyre në aspektin profesional, se çka duhet të bëhet dhe çka do të arrijmë nëse i ndajmë vetëm 10 mijë euro e të dërgohet ndonjë kompani e që mund të ngjan diçka e papritur, me ato pak mjete të tilla e llogarisim që të arrijnë ekspertët nga niveli qendror e baza të tilla të punohet reth sanimit në Restelicë. Lidhur me rrugët, po theksoj se ne kemi 3 përfaqësues në nivele qendrore e 2 delegat në Kuvendin e Kosovës dhe atë nga Restelica dhe

nevoiten konsultat për bashkveprim e nuk mund të bëjmë asgjë, nëse parashohim vetëm 10 mijë euro. Sa u përket mjeteve për sufinansim, të ndajmë për sufinansim me donatorë, nga se ato do të shfrytëzohen për atë qëllim dhe, është fati të kemi donatorë, e kështu edhe ne do të jemi të përgatuitur për këtë qëllim.

Kryesuesi- Kalojmë në votim...? 22 “për”, dhe 1 “kundër (z.Hajrudin Hoxha), konstatoj se miratohet ky P/Vendim...

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kalojmë në pikën e IV-të rendit të ditës-P/Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin në Rregulloren mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale dhe fjalën e ka drejtori i DEF-ve Valon Shabani.

z.Valon Shabani- Siç e dini, kjo Rregullore është nga viti 2012 e kjo paraqet njerën nga punët më të mira që ka bërë Kuvendi për bizneset që veprojnë te ne. Kjo është ndihëmesë e vogël, por përkrahje e madhe, pasi se, krahasuar psh.me Prizrenin, jemi në përparësi, nga se ata një Rregullore të këtillë ende nuk e kanë miratuar. Kjo Rregullore parashikon që bizneset që veprojnë në Komunën tonë, i të gjitha veprimtarive, të lirohen nga taksat komunale. Lartësia e taksave është e ndryshme dhe e ndarë në 3 kategori. Në bazë të çmimoreve që kemi, shuma më e madhe është 100 euro për furrtarët, që pra kjo Rregullore liron këto biznese të paguajnë taksat. Edhe bizneset e regjistruara para kësaj date, lirohen nga taksat. Nëse biznesi ka paguar 120 euro të taksës, tani nuk e paguan, por kjo nuk do të tjetër se lirohen nga pagesa e tatimit në pronë dhe obligimet tjera.

z.Samidin Xheladini- Edhe ne, si GP (LDK), e përkrahim këtë iniciativë dhe paraqet punë të mirë dhe, siç ka qenë punë e mirë në të kaluarën, të vazhdohet me lehtësimet këtuilla të përkrahjes. Ato biznese që janë liruar, deri tani, duhet të janë të sinqerta dhe të paguajnë obligimet tjera, siç janë tatimet, pasi se, në të shumtën e rasteve, vërhet neglizhenca në pagesën e obligimeve shtetërore dhe ndaj Komunës.

z.Velid Haxhisin- Po theksoj se kjo Rregullore është e mirë dhe e mirëseardhur për bizneset e komunës sonë të cilët dëshirojnë të themelojnë firma. Por, edhe pse ka vetëm 2 nene, kam vërejtjen te neni 6/b lidhur me hyrjen në fuqi të saj se “hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi” dhe në nenin 6/c të thuhet “me Rregulloren e re shfuqizohet Rregullorja e mëhershme”.

z.Nexhat Isufi- Duhet të theksohet qartë se bizneset nuk lirohen nga taksat komunale, por të ceket se cilat taksat e biznese lirohen, a është fjala për tatim në biznes? Psh.vitin e kaluar kemi pasur një propozim dhe, disa që kanë pasur biznese, kanë thënë se nuk i paguajnë ujin, mbeturinat, pasi se jemi të liruar nga tatimi e, realisht, të gjitha ato janë taksat komunale?! Prandaj, kërkoj që, decidivisht, të caktohet se nga cilat ngarkesa lirohen, që qytetarët që dëshirojnë të themelojnë biznese të reja, të dijnë saktësisht se nga cilat taksat lirohen, pasi se kur të dëgjojnë këtë qytetarët, mendojnë se janë liruar nga të gjitha obligimet e taksat komunale?

z.Valon Shabani- Reth kësaj çështjeje duhet të sqarohen gjërat, me këtë P/Rregullore bizneset lirohen vetëm nga taksat komunale të firmës, që do të thotë se nuk janë të liruar nga pagesa e mbeturinave, ujit dhe çështjeve tjera komunale. Kjo është taksë vjetore dhe, nëse një person hap firmë të re, duhet të paguan taksë vjetore në atë firmë dhe psh.unë e hapi një kiosk, e kemi pasur një Rregullore të këtill më 2012, do të thotë kjo nuk është Rregullore e re, por vazhdimësi e Rregullores ekzistuese e cila është miratuar atëherë dhe ai që hap biznes të ri, edhe pse është i liruar nga pagesa vjetore e biznesit. Pra, nuk ka lirime nga obligimet tjera.

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime tjera, kalojmë në votimin e kësaj P/Rregulloreje...? Votohet, unanimisht.

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Në pikën e V-të kemi rishikimin e Vendimit të MAPL-së lidhur me themelimin e Komunitete dhe, siç dihet, MAPL-ja ka këthyer atë Vendimin tonë, pasi se kërkohet përfaqësimi reciprok gjinor 50:50%. Por, duke pasur parasysh se Komiteti ynë ka 7 anëtarë, ka qenë e pamundur të jetë ashtu. Kjo vërejtje ka vlejtur edhe për komitete tjera e ne te KPFinanca kemi “diskriminim pozitiv” dhe, sido që të jetë, obligimi ynë ka qenë t’u përcjellim atë shkresë në Kuvend e të shohim se çka më tej, hapi diskutimet...

z.Velid Haxhisin- Edhe unë pajtohem se ky Komitet nuk është i themeluar si duhet e që duhet të zgjerohet. Por, do të thosha se në ligjet tona mungojnë zbrazëtira të tilla dhe, nodshta, kjo ka qenë evidente te zgjedhja e barabartë e gjyqëtarëve në gjykata, por në rastin tonë kjo nuk e mundur, pasi se kemi kufizimin që komiteti ynë të ketë 7 anëtarë e, kjo paqartësi ligjore, po na krijon probleme e përfaqësimi i barabarë, logjikisht, ka qenë i pamundur e ne raste të këtilla kemi edhe në Parlamentin e Kosovës e që pra, shumë gjëra, nuk po mund të realizohen.

z.Zinaida Elmazi- Pajtohem me kolegun Velid H. dhe kërkoj që ministritë të kanë konsideratë ndaj vendimeve tona, sepse “non-stop” po na bëjnë vërejtje të këtilla dhe, pse pra këtë përfaqësim gjinor nuk po e kërkojnë edhe nëpër institucionet tjera ku femrat, nuk janë të përfaqësura 50:50 e që, në asnjë institucion, nuk kemi drejtoresha e caktuar e kjo po kërkohet për komitete?!

z.Samidin Xheladini- Nëse nuk do të kishte ligje që përcaktojnë ndryshe, ne siç jemi, do të emronim, në tërë botën, vetëm meshkuj për të vepruar sipas inateve tona e tani ka ardhur koha që këto çështje të zgjidhen Ne, si parti politike (LDK), atë ditë kemi propozuar 2 femëra dhe 1 femër dhe ne u kemi dhënë prioritet femërave, kurse ju të tjerët këtë nuk e keni respektuar dhe, nga kjo arsye, propozoj që këtij Komiteti t’i shtohen edhe 2 femëra, pra njëra, atë që kishim propozuar ne z.Adelisa Krasniqi dhe një femër tjetër të propozohet e kështu do të zgjidhim problemin.

z.Refik Latifi- Po flasim për Vendimine MAPL-së lidhur me themelimin e Komunitete te ne, se nuk qenka zbatuar Ligji në aspektin gjinor. Në këtë Komitet, gjinia femërore nuk është e

përfaqësuar as me 30% e tani kërkohet 50:50% dhe unë jam i mendimit që përfaësimin të jetë 4:3 e ligjërisht kemi mundësi t'a bëjmë edhe 5:4 anëtare, që e lejon UA, apo të shfrytëzohet mundësia tjetër që të bëhet ndërrimi me anëtare nga KPFinanca, ku ka më shumë femëra. Po ashtu, ekziston mundësia ligjore, që komuniteti jo shumicë, të jep edhe një anëtare që nuk i përket Kuvendit?

z.Granit Rifaj- Unë i dëgjova kolegët për ofrim të mundshëm të zgjidhjes sipas formulës që e kemi pasuar paraprakisht, pasi se, nëse fillojmë me shtim të anëtarëve jasht Kuvendit, do të krijojmë shumë punë për Kuvendin dhe mundemi t'a bëjmë edhe atë që partitë politike "Vakat"-i apo LDK-ja të bëjnë ndërrimin e anëtarëve nga një komitet në tjetrin, sepse mundësi tjetër këtu nuk ka?

z.Zaim Hajredini- Lidhur me këtë çështje fajin e ka edhe MAPL-ja edhe ne dhe, si është e mundur që Kuvendi i i cili ka 30% femëra me 70% meshkuj, të themlohet komiteti tani 50:50% dhe psh. si të gjenden tani, bie fjala 3,5 femëra, në përbërje të këtij Komiteti e që, faktikisht, në komitetet tona po bëhet diskriminim ndaj meshkujve?! Pra, kjo kërkesë e MAPL-së 50:50% është e pamundur me numrin e komitetit 7 anëtarësh, apo të bëhet zgjerimi me 9 anëtarë, pra 5:4, apo të bëhen korigjime në komitete me anëtarët ekzistuesë, në të kundërtën, Vendimi ynë të mbetet në fuqi e të presim mendimin tjetër të MAPL-së, për të vepruar pastaj.

z.Nexhat Isufi- Ky është rekomandim i MAPL-së se nuk paskemi vepruar mirë dhe kanë kërkuar revidim të Vendimit tonë, e ju, atë ditë, shtyeshit se cili do të futet në listat e komiteteve e tani po duhet t'a përmirësojmë atë Vendim në Komunitete dhe heqeni një anëtare nga KPFinanca e të caktohet në Komunitete dhe, të jemi të sigurtë, se gjithmonë kur kemi vepruar për veti, atëherë na kanë dal probelemt. Praksa, ka qenë që subjektet partiake, paraprakisht, të merren vesh për përfaqësim në komitete e kjo nuk ka ngjarë kësaj radhe e që kërkohet zgjidhje 50:50%.

Kryesusi- Nga Ministria kanë kërkuar përmirësimin e barazisë gjinore dhe, siç po shifet edhe tani disponimi, kërkohet që ajo të mbetet, siç ka qenë, apo të bëhen konsultime mes partive politike?

Kryetari- Meqenëse shkresa i është adresuar kryesuesist të Kuvendit, nëse ju kujtohet, kur kemi përcaktuar "formulën" e përbërjes së komiteteve kemi theksuar respektimin e barazisë gjinore, por gjendja ka qenë e atillë, siç është votuar dhe tani po shoh disponimin e disa delegatëve që të shtohet numri nga 7 në 9 anëtarë? Dua të them se përfaqësimi me anëtarë-jasht Kuvendit nuk është i lejuar, pasi se të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në Kuvend. Ju e dini se këtë e përfshin edhe UA ku theksohet se, nëse një komunitet nuk është i përfaqësuar në Kuvend, duhet të plotësohet me përfaqësim në Komiteteve dhe tani kemi vetëm mundësinë që partitë politike shqiptare, në vend të mashkullit, të caktojnë femër për t'u afruar përqindja e 50% e zgjidhje tjetër nuk ka, apo me "rokada", nga njëri komitet në tjetrin?

Kryesuesi- Propozoj 5 minuta pauzë, që përfaqësuesit e partive politike të konsultohen për ofrim të zgjidhjes.... Por, edhe pas konsultimeve, nuk ka ndryshime konkrete.

z.Samidin Xheladini- Sa i përket përbërjes së KKomuniteteve, neni 9.2 thekson se ai përbëhet nga anëtarë të komunitetit jo shumicë që janë të përfaqësuar në Kuvend dhe jasht tij, që do të thotë se, nëse komuniteti jo shumicë nuk ka anëtare tjetër, ka të drejtën e propozimit të një anëtareje nga jasht Kuvendi e kjo do të vinte në shprehje, pa e shkelur Ligjin. Ne mund të kemi anëtare nga komuniteti joshumicë, që nuk është e përfaqësuar në Kuvend?

Kryesuesi- Të gjithë këtu jemi për zgjidhje dhe po propozoni, si njeri dhe tjetri, por ky është që është KKomuniteteve.

z.Granit Rifaj- Ne kemi përsëritur se nga Kuvendi nuk ka përfaqësues tjetër për këtë Komitet dhe kryesuesi mirë e dha propozimin. Siç e dini, ne – si PDK, jemi partia më e madhe në Kuvend e, nëse duhet propozim tjetër e japim ne e mos të shkohet kah bllokimi i punës, duke u kthyer nga fillimi, kurse nëse fillohet prej fillimit, kryesuesi nuk llogaritet si propozim partiak, por sipas funksionit-automatizmit.

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi propozime tjera, kalojmë në votim, që Vendimi të jetë, siç ka qenë...? “për”-18, “kundër”-8 dhe të “përmbajtura” 0 vota, që do të thotë se miratuar Vendimin, siç ka qenë paraprakisht.

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës -“eventuale”...

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë - “eventuale” , urdhëroni...

z.Sefidin Mejzini- Pëshëndes të gjithë dhe drejtorët (edhe pse disa lëshuan seancën), kam një kërkesë për kryetarin e Komunës i cili është në një far mënyrë relaksuese, pasi se i përket sportit. Natyra na ka falur-dhuruar shumë gjëra të mira të cilat mund t'i shfrytëzojmë në mënyrë pozitive, për vendin dhe fëmijët tonë. Z.Kryetar të hapim një shkollë është çështje më e mirë që mund të bëjmë për komunitetin tonë, të sigurojmë një troll të cilin na ka fatë nëna natyrë e këtë mundemi, nëse dëshirojmë. Flas për lokalitetin në “Mejdan” i cili, ka kohë, që kërkon një stadium e aty janë luajtur mjaft ndeshje e askush nuk e pati fatin që të vendos themelin e këtij stadiumi. Jam i vetëdijshëm se në këtë lokalitet apo pjesën e tij e menaxhon AKP-ja, por nëse ekziston dëshira e mirë, kjo mund të sigurohet. Unë jam i vetëdijshëm se ka edhe mendime ndryshe për këtë rast, por ky rast nuk është personal, por foli për të mirën e të gjithë neve dhe fëmijëve tanë. Ekzistojnë njerëz të vullnetit të mirë, të cilët më kanë kontaktuar, si dhe Ambasada Turke të cilës i është bërë Kërkesa e ata janë të gatshëm të veprojnë, por ju nevojitet një dokument apo Pëlqim që komuna të ndan një troll të tillë e ata do të rregullonin terrenin, të vendosin rethoja për stadiumin dhe nevojat tjera për këtë. Kjo nuk kërkon çmim të lartë, pos dëshirës së mirë nga ne. Ne, qe 3-4 orë po bëjmë fjalë për mjete të cilat po na shkojnë në suficit e të dashurosh sportin do të thotë të duash edhe kulturën. Unë e di se këtu ka mjaft anti-sportistë, por të jesh akulturor është abstrakte e kjo është kërkesa ime, që në bashkëpunim me kryetarin e nuk po kërkoj asgjë për fshatin tim dhe se di se ka troje dhe terrene sportive edhe në fshatra tjera, si Blaçi apo Breznja, por lokacionin të cilin e përmenda është epiqendër, pasi se fëmijëve

nuk u duhet as transporti dhe kjo që flas tani, ndoshta, nuk do t'i pëlqen z.Samidin Xh. dhe, edhe pse mjetet po na shkojnë në suficit, unë nuk po kërkoj mjete nga Komuna, por Pëlqim për ndarje të atij trolli. Z.kryetar, tani e keni shansin që në atë pjesë të ketë një stadium e kjo ty do të nevojitet edhe politikisht dhe, ndoshta, do të dëshiroja që këtë t'a dhuron dikush nga partia ime-LDK-ja e për ju kjo do të ndikon pozitivisht-politikisht. Pra, nevojitet dëshira e Komunës, që në bashkëpunim me AKP-në të bëjnë diçka të mirë për komunën tonë.

z.Naser Myrtezani- "Sot do të paraqes disa shqetësime të mia, si delegat, por edhe shqetësime të shumë qytetarëve të komunës sonë. E para- ka të bëjë me arsimin, konkretisht, punëtorët e arsimit që kanë dal dhe po dalin në pension. Këtë vit, në sektorin e arsimit dalin në pension një numër i madh punëtorësh-diku reth 27 veta. Dhe, sipas Marrveshjes me MASH-in, atyre duhet t'u jepen nga 3 paga. Por, deri tani, këta punëtorë që kanë dalur në pension nuk i kanë marr ato 3 paga nga Komuna dhe janë detyruar të ndjekin procedurat gjyqësore, ku ato të drejta atyre u kushtojnë 10% të pagës dhe plus shpenzimet tjera. Andaj, çfar do të bëni Ju dhe a do të jepen ato paga për të cilat ata janë shumë të interesuar të dijnë se çfar do të ndodh me ato 3 pagat e tyre? E dyta- çështja ka të bëjë , prap, me arsimin. Këto 2 ditë është hapur Konkursi për punëtorë arsimor në disa shkolla të komunës së Dragashit. Unë, pyes kryetarin se këto punësime që do të bëhen, a do të bëhen sipas meritave të atyre që kanë konkurruar, apo do të ndosh ajo, siç ka ndodhur deri më tani, ku ende pa u shpallur Konkursi, po dihet se kush do të punësohet dhe në cilën shkollë?! Pra, deri më tani, punësimet kanë qenë punësime partiake dhe, vitin e fundit, edhe punësime familjare. E treta-shqetësim është edhe çështja tjetër lidhur me Zyrën e KEDS-it të inkasimit në Bresanë, që e pyes kryetarin se a jeni në dijeni pse është mbyllur kjo Zyrë dhe a jeni në kontakte se a do të ketë, prap, KEDS-i atë Zyrë në Bresanë? Qytetarët e fshatit Bresanë, që është ma i madhi në Komunën tonë, nuk e meritojnë një ndëshkim të tillë, pasi se ajo Zyrë e Inkasimit është tejet e rëndësishme edhe për pjesën më të madhe të fshatrave të Opojës, sepse qytetarët janë të habitur dhe të zhgënjyer me këtë veprim dhe mos angazhimin e Komunës për t'u të këthyer prap atë Zyrë në Bresanë? Tash qytetarët po duhet të gjejnë mënyra tjera të pagesës së energjisë, ose të vijnë në Dragash. Ndërsa, jo më larg se në seancën e kaluar, KEDS-i ka kërkuar vendosjen e 2 trafave elektrike në Brod, që u votu me shumicë votash dhe atë me mos pagesë së kompenzimit Komunës, kurse Zyrën me interes për Komunën e kanë mbyllur?! Unë, prap, po kërkoj, si qytetar, që të bini në kontakt me KEDS-in që pagesa të bëhet prap në Bresanë? E katërta- ka të bëjë me kanalizimin e f.Zaplluxhe, pasi se ai kanalizim është i bllokuar dhe është prishur në tërësi. Aty është punuar me gypa të plastikës dhe, tërë ata gypa me ujëra të zeza janë dal mbi dhe. Rrebeshi i parë i shiut i ka nxjerr të gjithë jashtë tokës dhe ai kanalizim, i tëri, është jo funksional, kurse ka kushtuar bukur para të qytetarëve të Komunës, sepse, sa herë që ka reshje të shiut, qytetarët janë të rrezikuar dhe gypat janë shpërndar gjithandej nëpër lum e jashtë lumit-nëpër natyrë në tërë fshatin! Dhe është për t'u çuditur sesi investohet diku dhe mos të mbikëqyrë askush punime?! Këtë po e theksoj nga se nuk ka qenë asnjë zyrtar komunal për t'u parë sesi po shkojnë punimet, si dhe nuk ka qenë askush as kur janë kryer punimet dhe është për t'u habitur se si lëshohen mjetet atyre punëkryesëve, kur nuk punohet në mënyrë të rregullt?! Andaj, ai kanalizim duhet i tëri të nis nga fillimi, s'pari të

pastrohet nga gypat që kanë dal nga lumi e të pastrohen ato mbeturinat që po i hedhin qytetarët që nuk i paguajnë ato e të sigurohet pastaj se si do të punohet e për këtë dikush duhet të jap llogari?!

z.Velid Haxhisin- Unë do t'i kisha dhënë disa sugjerime kryesuesit të Kuvendit, që, në bashkëpunim me Shërbimin, të bënë një map se ku dhe si do të ulen delegatët dhe të thirren me emër e mbiemër dhe në fund të miratimit të vendimeve të konstatojnë me zë se cili vendim u miratua dhe me sa vota dhe kush ishte "për", "kundër" dhe "i përmbajtur". Mund të kuptoj se kryesuesi është fillestar, por që ngadal mund të zbaton praktikën e këtillë, pasi se po kemi mospajtime e dilema se kush do të duhet të dal para foltores dhe cili vendim me sa vota është miratuar. Çështja tjetër që do të theksoja është ajo se i pyes delegatët se athua dikush nga ju e din se ku ndodhet fshati Jazhince në komunë tonë dhe, nëse nuk e dini, ne kemi pasur një projekt të ndërtimit të rrugës kah kufiri me Shqipërinë, konkretisht kah fshati Borje, ku atje qëndron një shenjë orjentuese kah ky fshat? Unë si qytetarë i kësaj komune, dhe as qytetasrët që kam konsultuar, nuk e dijnë se ku gjendet ai fshat. Kjo është përgjegjësi, para së gjithash e Inspektorit të Trafikut e jo e punëkryesit. Do të apeloja në kryetarin që t'i rekomandon Inspektorit që tabelat e tilla të largohen, si dhe rasti i kufizimit të shpejtësisë në hyrje të f.Krushevë prej 20 km. që është rast, ndoshta, i vetmi në botë e që për shoferët paraqet problem se a të ndalojnë automjetet, apo të vazhdojnë?! Pra, ajo shenjë nuk i plotëson kriteret dhe mendoj se nuk është vendosur sipas nevojave për kufizim të tillë të shpejtësisë, apo firma punëkryese nuk ka pasur shenja tjera dhe e ka vendosur atë shenjë?! Kjo, ndoshta, nuk është temë për Kuvend, por pasi se deri tani nuk është reaguar, e ndiej nevojën që këtë t'a theksoj dhe në fund, komuna e jonë e ka ndar kamerën për inqizimin e e programit në gjuhën gorane, që paraqet metodë të mirë dhe paraqet afismimin e kësaj treve dhe të folurit lokal këtu, por njerëzit që paraqiten me deklaratat e tyre paraqiten me rastin e vizitës së ndonjë zyrtari serb, dëshon se mund të vjen te keqpërdorimi i saj dhe i mjeteve të ndara, që pra duhet kujdes dhe i ftoj ata njerëz për kujdes dhe të dijnë se ku gjenden dhe keni e përfaqësojnë?!

Kryetari- Po ju kërkoj falje, pasi se më presin në takim përfaqësuesit e e UNDP-së e që më duhet të lëshoj seancën dhe t'u jap përgjigje në seancën e radhës.

z.Samidin Xheladini- Unë, z kryetar, në seancën paraprake kërkoja Listën subvencioneve dhe Listën e pagave, si dhe plotësimin e gropave në rrugë që është nevoj urgjente dhe pse ato lista nuk na dërgohen dhe kur do të na sillen?!

Kryetari- Sa u përket subvencioneve, s' shpejti do të keni atë Listë-bashkarisht me Raportin. Listat e pagave, këtu duhet të jemi të kujdeshëm se nuk guxohet të hyhet në çështje të shënimeve private të punëtorëve. Nëse jeni të interesuar për ato lista, ektzistojnë procedurat dhe paraqitni kërkesë për çasje në dokumente zyrtare. Sa u përket gropave, presim që të vizitohemi nga MInfrastrukturës gjatë muajit prill e të shifet se çka mund të bëhet.

z.Selman Osmani- Kryetari mund të shkon, por kryesuesi i Kuvendit është këtu dhe kemi përfaqësues nga partia e tij-PDK, që do t'ia përcjellin pyetjet. Ne këtu kemi një sërë pyetjesh që duhet t'i prezentohen kryetarit. Unë nuk kam marr përgjigje e që besoj se kryetari do të përgjigjet lidhur me çështjen kontestuese të zgjedhjes së nënkryetarit të Komunës, për komunitete se a ka marr përgjigje nga MAPL-jam, pasi këtë e kemi kërkuar e debatuar në seancë paraprake e këtë i lus përfaqësuesit-delegat të PDK-së t'ia përcjellin kryetarit për përgjigje në seancën e rasdhës. Ju lutem, kjo paraqet çështje serioze dhe mos t'a anashkalojmë dhe, nëse një komunitet meriton nënkryetarit-ne ta gëzon atë të drejtë. Mos të shkilet Luigji në fillim të mandatit tonë e mos të dikutojmë çështje tjera e të anashkalojmë temat me rëndësi kyçe për Kuvendin. I vetmi komunitet ndaj të cilit është bërë majorizimi është ai Goranë, pasi se është zgjedh nënkryetari nga komuniteti Boshnjakë e kjo është njëjtë sikurse në Prizren të ishte zgjedh Ashkali, Turk e që nuk udhëheqet ndaj Boshnjakëve atje. Për këtë ne duhet të kryejmë detyrat që i kemi, që kryetari të propozon pjestarin e komunitetit Goran për nënkryetar të Komunës, për komunitete.

z.Granit Rifaj- Pasi se pyetjet po i adresohen direkt kryetari, më mirë që ato t'i lëmë për seancën tjetër. Ndërkaq, sa i përket nënkryetarit për komunitete të Komunës, kjo, ndoshta, nuk varet nga kryetari dhe se ai është propozuar nga kryetari, por që ka qenë i pranueshëm dhe i votuar nga shumica e delegatëve të komunitetit jo shumicë e pastaj edhe nga ata të shumicës. Në shkresën e MAPL-së, kryetari dhe organet e tij kanë dhënë përgjigje dhe ajo përgjigje është duke u shqyrtuar dhe, kur të jepet ajo përgjigje, nëse ka nevojë, përsëri do të votohet. Por, unë mendoj se më mirë kështu se sikurse herën e kluar-para 4 viteve të ngelni pa nënkryetar nga përkatësia "Goran apo Boshnjak" e që, shiqar realisht, ju jeni një popull. Këtë janë probleme që ju duhet t'i zgjidhni në mes vedit e jo të na i orjentonin neve?!

z.Rexhep Kamberi- Kërkoj nga kryetari apo kompetentët tjerë që të na jepet përgjigje lidhur me Kërkesën-Peticionin e banorëve të f.Dikancë e Mlik e që e kemi të bëjmë me dëmet e frikën që atyre u shkaktojnë familja e blegtorit Beshir Dauti nga Brodi, me qentë e tyre e ne këtë e kishim dje në mbledhjen e Komunitete. Ata, për dëmet dhe frikën që u shaktohet, janë drejtuar edhe në gjykatë, por pa efekt e që ka nevojë të angazhimit të pushtetit lokal dhe përfaqësuesëve të komunitetit jo shumicë. Probleme të këtilla kanë edhe banorët e f.Vraniç e që ka nevojë të angazhimit të mirfillt të organeve komunale-ekzekutive dhe të atyre legislative, përfshi këtu edhe Policinë dhe Inspektionin.

z.Selman Osmani- Nuk do të thotë që Kuvendi duhet të përkujdeset edhe për atë se kush ku do të kullohet bagëtitë dhe të jemi konkret në paraqitjen e pyetjeve?

z.Zinaida Elmazi- Më falni, por do të bëj disa pyetje e sugjerime dhe dëshiroj të më dëgjoni e mos u largoni nga mbledhja. Po theksoj se ka kaluar një vit nga zjarri në Shtëpinë e Kulturës në Dragash e nuk është folur pothuaj asgjë? Pra, asgjë për rastin dhe mua më intereson se cilat janë humbjet e Komunës, të pronarëve, si dhe nuk kemi informata për shkakun e zjarrit. Në seancën e kaluar e kam

përmendur Zyrën për Barazi Gjinore dhe më vjen keqë që sot koleget e mia e lëshuan seancën e nuk po kanë mundësi të dëgjojnë e që kam theksua se komuniteti jo shumicë po diskriminohet nga kjo Zyrë. Unë, si përfaqësuese e subjektit politik-“Vakat”, nuk kam dëshiruar bashkëpunim e ky është problem personal, nga arsytet që i di unë, por që “Vakat”-i nuk më ka vetëm mua - si femër, por pse në aktivitet nuk e kyçës asnjë femër tjetër të saj. Ne që jemi më të vjetra këtu e dijmë se kemi reaguuar ndaj kësaj Zyreje që nga viti 2007, por asnjëherë nuk kemi marr përgjigje transparente nga ajo Zyrë e përgjegjës të saj. Kjo Zyrë ka filluar punën që moti dhe ka pasur e ka pasur probleme me kyçjen e grave në institucione e unë dhe kolegja ime nga GIG-u kemi apeluar që të themelohet Bordi i Grave e që e kemi bërë. Tani s’ shpejti kam dëgjuar një informacion apo dezinformacion, nëse është i saktë, e kjo ka të bëjë me konstatimin se gjoja z.Zinaida E. nuk dëshiron të bashkëpunon me këtë Zyrë, pasi se është nacionaliste e për çka unë qenkam nacionaliste?! Unë po theksoj se jam ndër të parat femëra këtu që jam kyçur në shoqërinë kosovare, jam e para që i kam udhëhequr nënat e dëshmorëve në ekskursione e ku janë vizituar vendet ku kanë rënë të dashurit e tyre. Më 2007 kam dhënë propozim e, e aty kanë qenë edhe zyrtarët e OSCE-së, se si të kyçen gratë tona në zgjidhjen e problemeve të tyre shoqërore. Janë përkrahur 2 projekt-ideje të miat e ata janë për rrobaqepësi dhe për floktare(ondulim) e që do të thotë se atëherë kemi përfituar maqinat qepëse industriale dhe rekuizitat për sallon ondulimi për femëra, në mënyrë që femërat të mbajnë kurse dhe punojnë e reagimi i parë ishte atëherë kur ato makina e paisje kalun tek sektori joqevritar OJQ. Distancimi im i dytë është në Prevallë në hotel “Sharri” ku ishte organizuar seminari i UNDP-së s’ bashku me z.Marija Elena e ku ZBGjinore paraqet problemet e barazisë gjinore në Komunë. Problemin e mos integritit të komunitetit jo shumicë ne e kemi qe shumë kohë në arsim-pasi se femërat tona nuk po vazhdojnë shkollimin e disa janë të kyçura në sistemin arsimor të Kosovës e disa në atë paralel. Por, të parat tona kanë qenë të kyçura në rrjedhat shoqërore e institucione në vitet e 90-ta e që kanë qenë edhe z.Hatixha Sheh e mos të thuhet se fëmijët tanë janë të pa shkolluar, por përkubndrati kemi nëna që lindën mjek të mirë të cilët po i ndjekim për të mjekuar, artistë e sportistë të njohur me të cilët mburret Kosova dhe kjo, vërtetë, më ka irituar dhe, definitivisht, jam distancua nga kjo Zyrë. Këtë desha t’a dijnë kolegët e koleget e mia këtu në Kuvend se nuk jam nacionaliste, se dëshiroj bashkëpunim, por jo në mlënyrë siç dëshiron kjo Zyrë. Për mua nuk është me rëndësi se ado të shkoj në ndonjë drekë për 8 Mars dhe se ado të fotografohem e bëj “selfi” për t’i plasuar në Facebook, pasi se kjo nuk më intereson. Të nderuar-a, këtë Zyrë ka realizuar me mijëra projekte, kanë shëtitur koleget e mia e këtu kanë sjell aplikacionet për mëditje e, nëse dëshironi që të vazhdohet ashtu puna-urdhëroni, por mos llogaritni se prap do të fitoni 3-4 mandate-radhazi në Kuvend. Edhe diçka që më ka goditur emotivisht e që kam reaguuar përmes rrjeteve sociale në njerin nga web-sajtet e, pasi se kryetari mungon, i nderuari kryesues, koleg-e, kam reaguuar para 2 jave kur kam parë një rast rënqethës të një bashkatdhetari, për diçka që nuk e ka bërë e kjo ka të bëjë me atë se shifet nga avioni se diçka nuk është në rregull, që qent endacak dhe të blegtorëve lirisht shëtisin e nuk ndërmerret asgjë e banorët e fshtrave Mlik e Vraniç shpesh udhëtojnë në këmbë në Dragash, por që më nuk po mund të shëtisin lirshëm, pasi se një bashkatdhetar i ynë mezi ka shpëtuar nga qentë e familjes së

blegtorit-Beshir Dauti nga Brodi. Rasti i është paraqitur Policisë dhe është bërë intervenimi shëndetësor, por është frikësuar dhe po mjekohet ende e që dyshoj se do të tejkalon trumat e krijuara nga frika. Ky rast, mjerisht, nuk është i vetëm, pasi se qytetarët e kanë vështirë të udhëtojnë për në Dragash e detyrohen për udhëtime grupore, për t'u mbrojtur më lehtë. Unë do të kërkoja zgjidhje dhe këtë, prap, do t'a ngriti në Kuvend që të gjehet zgjidhje adekuate, sepse nuk kam asgjë kundër blegëtorëve.

z.Hatixha Sheh- Po ndërlidhem në rastin e Kërkesës-Peticion të banorëve të f.Dikancë reth dëmeve që po u shkakton familja e blegtorit Beshir Dauti nga Brodi të cilët u janë ankuar organeve komunale dhe kanë kërcunaur me alarmim të rastit në media dhe me ankesa tjera, nëse duhet do të përdorin të gjitha opcionet e mundëshme theksoj se do të shkojnë për drejtësi e mbrojtje edhe deri tek presidenti i Republikës së Kosovës z.Hashim Thaçi.

Kryesuesi- Nëse nuk kemi diskutime të tjera dhe mungon kryetari për përgjigje, me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit. Ju felemderit dhe mirë u pafshim në seancën e radhës.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu

z

